



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.02.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Genc Pollo – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë, zonjën Etilda Gjonaj Saliu, lidhur me zbatimin dhe ecurinë e prioritetit të dytë, të tretë dhe të pestë të Komisionit European. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Genc Pollo, Bledar Çuçi, Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Klodiana Spahiu, Aldo Bumçi, Grida Duma, Jorida Tabaku, Vangjel Dule, Viktor Tushaj, Klajda Gjoshaj

Mungojnë:

Arben Kamami, Taulant Balla, Sadri Abazi, Monika Kryemadhi

Të ftuara:

Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë

Teuta Vodo – Zëvendësministre e Drejtësisë

Elda Zenelaj – Drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave në Fushën e Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

(Diskutime në sallë.)

Genc Pollo – Zotërinj anëtarë të komisionit,

Duke ju uruar ditë të mbarë në fillim të kësaj mbledhjeje të thirrur ditën e premte, e di që është ditë e pazakontë për ju, por kjo ishte dita më e mundshme pas koordinimit që bëmë me zonjën ministre të Drejtësisë, të cilën e kemi sot në dëgjese (të cilën e përshëndesim bashkë me kolegët e saj), pra ishte e vështirë të bënim një mbledhje tri ditët e para të javës, siç është zakoni në punën tonë.

Para se të fillojmë me dëgjesën, të cilën e kemi pikë të vetme të rendit të ditës, dua të bëj dy njoftime.

Besoj se ju e mbani mend që para disa javësh vizitoi Shqipërinë, me ftesë të komisionit tonë, komisioni homolog i Parlamentit Portugez. Kryetarja e tij, zonja Bastos, më ka drejtuar një shkresë për të shprehur mirënjohjen për të gjithë Kuvendin e Shqipërisë për mikpritjen e treguar, e cila besoj se, në radhë të parë, ju takon juve, anëtare dhe anëtarë të komisionit tonë.

Njoftimi i dytë, që besoj se e keni marrë nga mediet dhe në rrugë të tjera, lidhet me Komitetin e përbashkët të Stabilizim-Asociimit, që u mbajt në Tiranë të hënën dhe të martën e kësaj jave, në të cilin disa prej jush janë anëtarë. Në përfundim ky Komitet i përbashkët miratoi rekomandimet që janë shpërndarë tashmë, ose do të shpërndahen te ju (në shqip dhe në anglisht), të miratuara me unanimitet nga të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe anëtarët e Parlamentit Europian, çka besoj se është sinjal pozitiv. E rëndësishme është të thellohem edhe në përmbajtjen e tyre, sepse pasazhe të rëndësishme të rekomandimeve shkaktojnë ende debat dhe nganjëherë polemika në diskutimet tona në komisione dhe në seancë plenare.

Le t'i kthehem tani çështjes në rend dite.

Siç e thashë, kemi të pranishme ministren e Drejtësisë, zonjën Gjonaj.

Besoj se ju kujtohet që kemi debatuar në dhjetor për të ftuar ministrat përgjegjës për fushat e caktuara të prioritetëve të integritetit europian, lidhur me përmbushjen e pesë prioritetëve, që janë kusht formal për të hedhur hapa të mëtejshëm.

Po i numëroj prioritetet, si i dyti, i treti dhe i pesti, të cilat janë kaluar me formatin që i mori qeveria e vjeshtës së shkuar nën kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë. Kështu që unë, në emrin tuaj, më 6 dhjetor kam ftuar zonjën Gjonaj, ministren e Drejtësisë, të vijë në dëgjese për të folur rreth realizimeve të prioritetit të dytë “Reforma në drejtësi”, prioritetit të tretë “Lufta kundër korrupsionit” dhe prioritetit të pestë “Mbrojtja e të drejtave të njeriut”.

Ministria ka dërguar një material me disa pjesë, të cilin ju e keni në dispozicion dhe shpresoj ta keni pasur mundësinë ta lexoni.

Sipas rregullit dhe traditës në këto raste, ia japim fjalën zonjës ministre, për të kaluar më pas në pyetje dhe/ose pyetje dhe diskutime.

Zonja Ministre, fjala është për ju.

Etilda Gjonaj – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të këtij komisioni,

Ndihem e kënaqur që komisioni po i kushton një vëmendje kaq të veçantë edhe dëgjësive me ministrat që mbulojnë prioritetet kryesore.

Aktualisht, Ministria e Drejtësisë mbulon tri prioritate kryesore dhe është përgjegjëse për to, pikërisht për reformën në drejtësi (prioriteti i dytë), për luftën kundër korrupsionit (prioriteti i tretë) dhe të drejtat e njeriut (prioriteti i pestë).

Në mënyrë periodike ka vijuar edhe përditësimi i planit të veprimit për pesë prioritetet e Komisionit Europian për vitin 2017; monitorimi i rekomandimeve të Nënkomitetit të Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë, për të cilat ministria është përgjegjëse; monitorimi dhe përditësimi i Planit Kombëtar për Integrimin Europian për vitin 2017-2020, si dhe hartimi i Planit Kombëtar për Integrimin Europian për vitin 2018-2020.

Ashtu siç edhe ju e thatë, Ministria e Drejtësisë ka dorëzuar një material të detajuar për sa u përket tri prioritetëve që mbulojmë. Në mënyrë të shkurtuar dhe të përmbledhur po përmend gjetjet dhe arritjet kryesore për vitin 2017, si dhe, njëkohësisht, do të bëj një prezantim të objektivave për vitin 2018, që lidhen pikërisht me këto tri prioritate.

Për sa i përket prioritetit të dytë “Reforma në drejtësi”, ashtu siç ju jeni në dijeni, kjo është ndër reformat më të rëndësishme që është ndërmarrë ndonjëherë, është ndër reformat që ka bërë një përmbysje të sistemit të drejtësisë qoftë për sa i përket mënyrës se si është i organizuar sistemi, qoftë për sa u përket tri parimeve kryesore mbi të cilat duhet të funksionojë pushteti gjyqësor: pavarësia, efienca dhe efektshmëria e sistemit të drejtësisë.

Është arritur pikërisht miratimi i paketës ligjore kryesore, asaj që quhet paketa emergjente me shtatë ligjet kryesore, që e kanë ndryshuar tërësisht sistemin e drejtësisë. Në muajin mars të vitit 2017, gjithashtu, janë bërë disa ndryshime në disa ligje materiale dhe procedurale tepër të rëndësishme, pjesë e kësaj pakete, si, për shembull, në Kodin e Procedurës Civile, në Kodin e Procedurës Penale, por ndryshime të rëndësishme janë bërë edhe në Kodin e Drejtësisë për të Miturit. Njëkohësisht, ka vazhduar pjesa e tretë e projektligjeve të identifikuar në momentin kur reforma në drejtësi u dizenjua për t’u miratuar dhe dy prej tyre

u miratuan në tremujorin e fundit të vitit 2017, që është pikërisht ligji “Për ndihmën juridike” dhe ai “Për tarifatat gjyqësore”.

Paketa e reformës në drejtësi nuk ka përfunduar ende, sepse jemi në fazën ku po rishikohen dhe po punohen projektligjet për profesionet e lira: projektligji “Për noterinë”, “Për përmbartimin”, “Për ndërmjetësimin” dhe ai “Për profesionin e avokatit”, si katër projektligje shumë të rëndësishme që përmbyllin paketën kryesore të reformës në drejtësi.

Ministria e Drejtësisë, në këtë proces të fundit të paketës ligjore për profesionet e lira, po jep, gjithashtu, kontributin dhe komentet e saj, me qëllim që të përmirësohen shërbimet që u ofrohen qytetarëve lidhur me këto profesione të lira. Madje, po shikohet mundësia që këto profesione të lira të mos jenë më thjesht pjesë e një pakice profesionistësh të lirë që i ofrojnë këto shërbime, përkundrazi, të jenë profesione të cilat mirëkontrollohen, ku licencat jepen në bazë të meritës, si dhe duhet ta shikojmë me shumë transparencë dhe kujdes pjesën e disiplinimit të atyre që ofrojnë shërbimet e lira ndaj qytetarëve.

Është shumë e rëndësishme për t’u theksuar se në Dokumentin Analitik që Ministria e Drejtësisë ka bërë për vitin 2018, pjesën më të madhe të akteve nënligjore e zënë pikërisht aktet që dalin për zbatimin e paketës kryesore të reformës në drejtësi.

Nëse Ministria e Drejtësisë në dhjetë vjetët e shkuar ka propozuar një numër të caktuar të akteve nënligjore, aktualisht, viti 2018 është viti në të cilin Ministria e Drejtësisë ka marrë një angazhim ambicioz, ku duhet të miratojë rreth 60 akte nënligjore, të cilat, ashtu siç jua përmenda, nuk janë bërë në dhjetë vjetët e kaluar.

Një aspekt shumë i rëndësishëm ka qenë pikërisht ngritja e institucioneve të reja.

Ashtu siç ju jeni në dijeni, qeveria shqiptare, e angazhuar në mënyrë tejet të jashtëzakonshme, ashtu siç i ka mbështetur me buxhet, i ka mbështetur me infrastrukturë, por edhe me strukturë institucionet e reja që kanë të bëjnë me vettingun e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, apo edhe të të gjitha subjekteve të rivlerësimit kalimtar.

Nga Ministria e Drejtësisë është bërë e mundur dhënia dhe vënia në dispozicion e ambienteve shumë të përshtatshme për këto institucione. Këtu e kam fjalën për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, Kolegjin e Apelit dhe Komisionerët Publikë, ku ndërkohë jemi duke punuar, sepse janë konsideruar si kusht tejet të rëndësishëm edhe nga Bashkimi Europian, me qëllim që këto komisione ta kryejnë veprimtarinë e tyre ashtu siç duhet. Gjithashtu, u është dhënë e gjithë mbështetja edhe për sa i përket strukturës, me qëllim që ata ta realizojnë të gjithë funksionin brenda të gjitha kushteve optimale. Madje, siç jeni në dijeni, shteti shqiptar, qeveria shqiptare, përveç pagës së parashikuar në ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve”, me vendim të Këshillit të Ministrave ka dhënë një shtesë page me 50% mbi pagën e tyre për anëtarët e këtyre komisioneve, gjithmonë me qëllim që funksioni i tyre dhe të gjitha përgjegjësitë ligjore të kryhen në mënyrën më optimale të mundshme.

Aktualisht, ne jemi duke punuar (është një punë që ka filluar që në tremujorin e fundit të vitit 2017) për ngritjen e institucioneve të tjera të reja, si për Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë dhe organet e SPAK-ut, të cilat janë organet kryesore që do të bëjnë të mundur fillimin e funksionimit të zbatimit të reformës në drejtësi. Janë pikërisht organet e qeverisjes ato të cilat do të fillojnë të parat, siç jeni në dijeni edhe ju, për miratimin e listës përfundimtare për sa u përket anëtarëve që vijnë jashtë sistemit për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë këtu EURALIUS-in, OPDAT-in, USAID-in dhe një sërë organizatash të tjera po punon për të ndërtuar skemën, strukturën, infrastrukturën, që ju duhet këtyre organeve, me qëllim që sapo të përfundojë procesi i vetingut për anëtarët kandidatë nga sistemi gjyqësor dhe sistemi i prokurorisë, të fillojë ngritja e institucioneve të reja dhe zbatimi i reformës në drejtësi.

Qeveria shqiptare është e angazhuar t’u japë gjithë mbështetjen buxhetore këtyre organeve të reja (kjo është arsyeja pse puna është pothuajse në përfundim), me qëllim që kur ato të ngrihen, të fillojnë menjëherë nga puna dhe të mos kenë asnjë pengesë për sa i përket pjesës infrastrukturore dhe buxhetore lidhur me ushtrimin e funksionit të tyre.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i reformës në drejtësi është respektimi i të drejtave të të miturve. Në muajin mars të vitit 2017 është miratuar Kodi i Drejtësisë për të Miturit. Sot, si detyrë kryesore, nga Ministria e Drejtësisë pritet ngritja e qendrave për rehabilitimin e të miturve, të cilët marrin dënime alternative nga gjykatat, duke iu ofruar atyre një mundësi trajtimi dhe rehabilitimi përpara se të mbarojnë dënimin apo edhe 6 muaj pasi e përfundojnë atë.

Për këtë arsye, në aparatin e Ministrisë së Drejtësisë është ngritur një strukturë e posaçme, që ndjek në mënyrë rigorozë të gjitha detyrimet që vijnë nga zbatimi i Kodit të Drejtësisë për të Miturit. Njëkohësisht, po punojmë edhe për paketën e akteve nënligjore me qëllim zbatimin e këtij kodi.

Për sa i përket reformës në drejtësi, është për t’u theksuar se së bashku me partnerët ndërkombëtarë po punojmë për strategjinë ndërsektoriale të drejtësisë, e cila i jep Ministrisë së Drejtësisë një rol të shtuar, që ka të bëjë me mekanizmin monitorues se si reforma në drejtësi po zbatohet. Njëkohësisht, po punojmë edhe për pasaportën e indikatorëve, ku do të ketë një

instrument matës nga Bashkimi European për të parë se si Shqipëria po ecën me zbatimin e reformës në drejtësi.

Këto janë elementet kryesore që kanë pasur arritje gjatë vitit 2017, të theksuara edhe për objektivat e vitit 2018, lidhur me zbatimin e reformës në drejtësi.

Shkurtimisht, doja t'ju jepja edhe disa gjetje dhe konkluzione për sa u përket dy prioritetëve të tjera, siç është lufta kundër korrupsionit.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave, ministri i Drejtësisë, sot, ka funksionin e Koordinatorit Kombëtar Antikorrupsion. Koordinatori Kombëtar Antikorrupsion është një ndër përgjegjësitë e shtuara të ministrit, me të cilat, unë kam filluar nga puna që në momentin e parë që m'u dhanë si përgjegjësi ligjore (së bashku me partnerë ndërkombëtarë, duke përfshirë këtu kryesisht delegacionin european), për të ndërmarrë si iniciativë rishikimin e planit të veprimit 2018-2020, me qëllim për ta bërë atë sa më shumë të evidentueshëm si në shifra, në prioritete apo edhe masat që qeveria shqiptare po ndërmerr në luftën kundër korrupsionit, por jo vetëm. Për sa kohë që ministri i Drejtësisë ka pozicionin e një koordinatori kombëtar, kjo përfshihet edhe te masat që institucionet e pavarura apo institucionet e tjera të krijuara me ligj, duhet të zbatojnë në kuadër të këtij plani kundër korrupsionit apo edhe në kuadër të strategjisë së madhe kundër korrupsionit.

Jemi duke punuar fort edhe për strukturën që është ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë në kuadër të koordinimit, monitorimit dhe raportimit të planit të veprimit për luftën kundër korrupsionit, ashtu sikurse edhe për strategjinë. Gjithashtu, jemi duke punuar edhe për një instrument tjetër, përsëri shumë i efektshëm dhe i matshëm për Bashkimin European, pasaportën e indikatorëve me treguesit kryesorë, ku qeveria shqiptare së bashku me institucionet e pavarura apo institucionet e krijuara me ligj, do të japin indikatorë të matshëm lidhur me luftën kundër korrupsionit.

Për sa i përket prioritetit të tretë, të drejtat e njeriut, tri fushat kryesore ku unë do të ndalem janë:

Aksesi në gjykatë. Qytetarëve u është dhënë akses në organet e drejtësisë me dy ligjet e miratuara në 3-mujorin e fundit të vitit 2017. Konkretisht, ligji për tarifat gjyqësore dhe ligji për ndihmën juridike, sjellin një qasje totalisht ndryshe për sa i përket mënyrës se si do të funksionojë ndihma juridike, si do të përfitojnë ato grupe vulnerabël për sa i përket aksesit në gjykatë, si do t'u jepet avokati falas për çështje penale, çështje administrative dhe çështje civile, por njëkohësisht edhe për ato target grupe të përjashtuara nga plotësimi i kriterëve vetëm për faktin se janë dhënë me rekomandime edhe nga mekanizmat ndërkombëtare, siç është ECRI,

ndërmjet konventës *Sida*-n apo nga instrumente të tjera, duke u përfshirë në ligj në mënyrë specifike që të përfitojnë ndihmën juridike falas.

Ministria e Drejtësisë ka si detyrim të ngrejë një drejtori në varësi të saj për të dhënë dhe ofruar mundësinë e ndihmës juridike, ashtu siç do të krijojë edhe zyrat, që do të funksionojnë në bazë të qarqeve apo rretheve gjyqësore, me qëllim që, si ndihma juridike parësore, ashtu edhe ndihma juridike dytësore të jepet për të gjitha kategoritë e individëve që do ta kërkojnë dhe do të kenë mundësi ta përfitojnë.

Deri sot, ndihma juridike falas, e ofruar nga Komiteti Shtetëror i Ndihmës Juridike, pothuajse nuk ka funksionuar. Unë e kam theksuar edhe kur është diskutuar projektligji. Kjo ka bërë që të mohohet akses i qytetarëve në organet e drejtësisë, kryesisht atyre që sot janë grupe më vulnerabël, duke mos pasur mundësinë e një avokati për t'u përfaqësuar në gjykatë. Për vitin 2018 na lind si detyrim jo vetëm ngritja e institucionit të ri, por njëkohësisht edhe një bashkëpunim shumë më të mirë me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, të cilat do të ofrojnë ndihmën juridike parësore.

Çështja tjetër në të cilën dua të ndalem ka të bëjë me trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve. Aktualisht, qeveria shqiptare dhe Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë një reformë në burgje. Qëllimi është bërja e një reforme në aspektin legjislativ, në aspektin infrastrukturor, por edhe në burimet njerëzore. Kemi filluar me mënyrën si janë rekrutuar drejtuesit e rinj të institucioneve penitenciare, nëpërmjet konkurseve, nëpërmjet transparencës dhe me kriteret për të përzgjedhur njerëzit më profesionistë, duke i dhënë një vlerë të shtuar kandidatëve me background ushtarak apo policor.

Gjendja në burgje në momentin kur kjo qeveri ka filluar mandatin e saj nuk ka qenë e mirë për shkak të kushteve dhe një gjendjeje të mjerueshme të përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit të stafit që ndodhet në këto institucione.

Nga një vlerësim i bërë së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, deri tani ka rezultuar që rreth 130 punonjës të Policisë së Burgjeve kanë qenë me rekorde penale. Për këtë arsye, ka filluar një procedim disiplinor për të parë nëse ata mund të qëndrojnë apo duhet të largohen. Në rast se nuk merren këto masa për këtë staf shumë të rëndësishëm, sidomos stafin policor që ndodhet brenda këtyre institucioneve, do të jetë i pamundur funksionimi normal i përgjegjshmërisë brenda këtyre institucioneve.

Po punojmë për të përmirësuar infrastrukturën e disa institucioneve penitenciare, të cilat janë vërtet në gjendje mizerabël. Brenda muajit shkurt, do të hapim edhe burgun e ri të Reçit,

në Shkodër, i cili ka një kapacitet të lartë, rreth 750 persona të dënuar dhe të paraburgosur, ndërtohet me fondet e Bashkimit Europian dhe pjesërisht nga buxheti i shtetit.

Duke pasur një burg dhe duke hapur një institucion të ri penitenciar, do të kemi mundësi të shmangim mbipopullim në burgje. Kjo na jep mundësinë për të rikategorizuar edhe një herë institucionet penitenciare, me qëllim për të risistemuar edhe persona me masa mjekësore. Një ndër rekomandimet, si të Bashkimit Europian, por edhe të mekanizmave të Këshillit të Europës, siç është CPT, është që të gjenden mundësitë, në zbatim të ligjit për shëndetin mendor, se si kjo kategori personash të mund të trajtohet në këtë mënyrë adekuate.

Gjithashtu, nga monitorimet dhe inspektimet që janë bërë deri tani në institucionet penitenciare, është vënë re që elementet e sigurisë kanë munguar. Kjo është parë edhe nga monitorimet që janë kryer për shkak të gjetjes së sendeve të ndaluara apo dhe lëndëve narkotike. Është shumë e rëndësishme të sigurojmë institucionet, me qëllim që ato institucione të mos i drejtojnë personat që ndodhen në to, por dora e shtetit, e cila të duket, të ofrojë siguri në këto institucione, por njëkohësisht, në kuadër të ligjit për trajtimin e të dënuarve, të trajtojë në mënyrë adekuate personat që ndodhen atje.

Shumë shpejt, Ministria e Drejtësisë do të sjellë në Kuvend edhe paketën e re ligjore dytësore penale, që përfshin ligjin për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, ligjin për ekzekutimin e vendimit penal, ligjin për shërbimin e provës, i cili, gjithashtu, vuan nga një problematikë e jashtëzakonshme, duke filluar që nga rasti i mosfunksionimit të mbikëqyrjes elektronike për shkak të elementeve, ndoshta jo të sigurt, që janë bërë në momentin kur janë tenderuar sisteme të caktuara për byzylykët që bëjnë mbikëqyrjen elektronike.

Njëkohësisht, në pjesën e paketës së dytë do të vijë ligji për Policinë e Burgjeve dhe ligji për shërbimin e kontrollit të brendshëm të burgjeve, që është një mekanizëm i ministrit të Drejtësisë për të monitoruar sistemet penitenciare.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme, për sa i përket prioritetit të të drejtave të njeriut, është çështja e pronave. Ashtu siç jeni në dijeni, në vitin 2017 Gjykata Kushtetuese nxori vendimin lidhur me ligjin për trajtimin e pronave dhe, në kuadër dhe në zbatim të këtij ligji, qeveria shqiptare në dhjetor të vitit 2017 miratoi dy vendime të Këshillit të Ministrave, me qëllim për të sqaruar dhe zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese, një kërkesë jo vetëm e Gjykatës Kushtetuese, por edhe e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, ashtu si edhe nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në të cilën janë në radhë pritje disa çështje të pronave. Ne po punojmë fort për të ridizenjuar edhe mënyrën e trajtimit të pronës, ku qeveria shqiptare ka ndërmarrë një reformë shumë të madhe për sa i përket kësaj çështjeje. Trajtimi i

pronës, është parë në aspektin ligjor, por edhe në aspektin e mënyrës së funksionimit, nëpërmjet një agjencie të integruar, ku integrohen çështjet e legalizimit, çështjet e trajtimit dhe të kompensimit të pronës, por njëkohësisht edhe të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim që nga njëra anë të pasurohet fondi i tokës për ata që do të kompensohen dhe nga ana tjetër të bëjë të mundur edhe shmangien një herë e mirë të problemeve që kanë 27 vjet që na shqetësojnë, që janë mbivendosjet apo ku një pronë del me më shumë se një pronar. Të gjitha këto çështje janë të përfshira në reformën e pronës, por me disa objektiva afatshkurtra për vitin 2018 ne po mundohemi që në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të fusim shërbimin *fast-track*, i cili u ofrohet investitorëve, bankave dhe veprimeve të tjera në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim që të mos kemi pengesa dhe bllokime për çështje, të cilat kërkojnë një zgjidhje emergjente dhe për të ulur ngarkesën e punës për zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në mënyrën e funksionimi normal.

Gjithashtu, një buxhet i konsiderueshëm i shtetit është vënë në dispozicion për kompensimin e pronarëve, me qëllim që edhe viti 2018 të ketë ashtu si viti 2017 një kompensim më të mirë, madje për vitin 2018 ne kemi një shtesë në buxhet, me rreth 700 milionë lekë, për të mundësuar më shumë kompensimin e një numri më të madh pronarësh.

Këto janë elementet kryesore. Jam e hapur për pyetje dhe për diskutime.

Genc Pollo - Faleminderit, zonja Ministre!

Besoj se komisioni e dëgjoi me vëmendje prezantimin tuaj, ku ju ngritët shumë çështje, që besoj se kanë nevojë për pyetje dhe shtjellim të mëtejshëm, por, para se të flas vetë, ndryshe nga herët e tjera, dua të pyes nëse kolegët kanë pyetje dhe komente për të bërë.

Zoti Dule ka kërkuar fjalën.

Vangjel Dule – Zonja Ministre, ju falënderoj për praninë dhe prezantimin tuaj në Komisionin e Integritetit!

Për të krijuar një ide më të qartë, dua t'ju parashtroj pyetjet e mëposhtme.

Lidhur me përbërjen e organeve, që do të kenë një rol shumë të rëndësishëm në drejtësinë e re, siç është KLP-ja dhe KLGJ-ja, u fol se kishte kandidatura, por edhe të përzgjedhur në përbërjen e tyre përfundimtare, të cilët në të shkuarën e tyre profesionale kanë vendime me karakter politik. A i konsideroni një rrezik politik dhe moral për drejtësinë e së ardhmes këta individë dhe si mendoni ta trajtoni këtë çështje në vazhdimësi?

Së dyti, një nga paraardhësit tuaj në Ministrinë e Drejtësisë, para disa muajsh ka njoftuar Kryeministrin për koston potenciale të vendimeve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut të Strasburgut, të cilat, në bazë të vlerësimeve të institucionit që ju drejtonit në atë periudhë

kohore, përbënte një rrezik për buxhetin e shtetit dhe financat shtetërore. A e ndani shqetësimin e paraardhësit tuaj dhe si mendoni ta trajtoni në të ardhmen këtë çështje?

Nga ana e opozitës, në vazhdimësi, ngrihen shqetësime në lidhje me ecurinë e reformës në drejtësi. Shqetësimi ynë është se nga një drejtësi e keqe, nga një sistem drejtësie jofunksionale, siç është kjo e sotmja, po shkojmë në një sistem tjetër drejtësie, i cili do të ushtrojë drejtësi selektive. Sa të shqetësuar jeni për këtë dhe a e konsideroni një sistem që ushtron drejtësi selektive më të mirë sesa një sistem më të keq drejtësie?

Ju faleminderit!

Bledar Çuçi – Duke marrë shkas edhe nga pyetjet e kolegut, një pjesë e tyre ishin shumë relevante, edhe me pozicionin e ministres sot, por aty ka edhe pyetje që nuk janë shumë relevante dhe dua nga kolegët që ta shfrytëzojmë këtë seancë për qëllimin që jemi mbledhur, lidhur vetëm me prioritetet. Nuk është dita sot të marrim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është e paprecedentë, por është e mbështetur në Rregullore. Nuk po komentoj, por po citoj Rregulloren e Kuvendit, e cila thotë se, kur ministrja vjen në seancë dëgjimore, duhet të përgjigjet për çështjet që është thirrur. Prandaj, unë them që ta shfrytëzojmë për këtë, sepse janë shumë çështje dhe mbulon më shumë se gjysmën e prioriteteve, të cilat lidhen me angazhimet e Shqipërisë për të hapur negociatat. Unë them të mos i kërkojmë ministres gjëra për të cilat ajo nuk është thirrur sot. Për t'ia ilustruar zotit Dule, ky nuk është vendi që ajo të japë opinione për figurat që kanë kandiduar apo që do të kandidojnë, sepse ky proces është i parlamentit dhe nuk është i qeverisë. Te pjesa e drejtësisë, ministrja është më shumë në rolin e reporteres, për të na thënë se çfarë është bërë deri tani me reformën në drejtësi, sepse rolin kryesor në reformën në drejtësi e ka parlamenti dhe për këtë besoj se biem të gjithë dakord. Unë them që ta shfrytëzojmë kohën në mënyrë sa më racionale.

Genc Pollo- Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nuk e di se sa e nevojshme ishte ndërhyrja juaj, por ftoj të gjithë kolegët që të mos diskutojmë relevancën e diskutimeve apo pyetjeve të njëri-tjetrit dhe të përqendrohemi te temat që janë në rendin ditës, për të cilat ministrja ka ardhur të relatojë. Temat janë aq të gjera dhe të plota sa mund të flasim deri pasdite, që shpresoj të mos ndodh. Pa humbur kohë dhe pa ndërhyrje të tjera, ndoshta të panevojshme, unë them që zonja ministre t'u përgjigjet pyetjeve.

Vangjel Dule - Zoti Pollo, më vjen shumë keq, sepse e kam kërkuar fjalën për një ndërhyrje shumë të shkurtër.

Së pari, ju falënderoj, por besoj se është e tepërt që në çdo sallë parlamentare, qoftë plenare apo në komisione, të hyjë tendenca se dikush mund të censurojë përmbajtjen e pyetjeve apo të pozicionimeve parlamentare. Ky është fenomeni më i rrezikshëm. Prandaj, mbajeni për sallën tuaj partiake, por jo për sallat tona parlamentare!

Së dyti, zoti Pollo, dua të theksoj që, nëse fati i reformës në drejtësi nuk është një çështje kyçe në fatin e procesit të integritetit, atëherë, nuk e di se kush mund të jetë. Prandaj, unë dua që kjo të jetë hera e fundit, të paktën me mua, që dikush të tentojë të censurojë përmbajtjen dhe natyrën e pyetjeve dhe të pozicionimeve.

Genc Pollo – Reforma në drejtësi, në radhë të parë, është e rëndësishme për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Së dyti, është e rëndësishme për integritetin europian.

Unë shpresoj që ministrja t'i ketë të gjitha kapacitetet për t'iu përgjigjur edhe pyetjeve për fenomene që lidhen me drejtësinë, por mund të mos lidhen direkt me veprimin e ministrisë, si ato të personave që janë zgjedhur në organet e reja të drejtësisë.

Zonja Ministre, pa humbur kohë me diskutime të mëtejshme, ju kërkoj t'u jepni përgjigje pyetjeve.

Etilda Gjonaj – Është e vërtetë, ashtu siç ju thashë, ne kemi miratuar Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, ku ministri i Drejtësisë ka një rol të shtuar në atë strategji dhe po përgatit edhe pasaportën e indikatorëve me asistencën e Komisionit Europian. Roli i shtuar i Ministrisë së Drejtësisë në këtë strategji është, pikërisht, monitorimi i zbatimit të reformës në drejtësi, cilët janë hapat, si po ndiqet, si po zbatohet, a po shkojmë brenda afateve të përcaktuara a po zbatohen ato brenda afatit të përcaktuar në ligj, edhe në kuadër të kësaj strategjie. Kjo do të thotë se nuk mund t'i futet meritës si është bërë përzgjedhja e anëtarëve të KLGJ-së, apo të KLP-së, apo çdo proces tjetër që ndodh jashtë Ministrisë së Drejtësisë, jashtë qeverisë shqiptare, ku pushtetet janë të ndara. Ky është një proces që është kryer nga Kuvendi. Gjithashtu, legjislativi e miratoi. Është përtej kompetencës së ministrit të Drejtësisë të komentojë, të gjykojë apo të vlerësojë pjesën e meritës të mënyrës së përzgjedhjes. Ministria e Drejtësisë në këtë pjesë shikon: vetëm nëse është zbatuar procedura e përcaktuar në ligj, dhe vetëm kaq. Në mënyrë absolute unë nuk mund të miksoj kompetencat e pushtetit legjislativ dhe pushtetit ekzekutiv, apo të miksoj kompetencat që i përkasin atyre organeve kushtetuese të krijuara, që bëjnë pikërisht rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pra, kjo është absolutisht shumë e qartë: qeveria shqiptare, Ministria e Drejtësisë mund të përgjigjet për pjesën e infrastrukturës, atë që ne kemi detyrim, për pjesën e buxhetit, që anëtarët e komisionit

dhe strukturat përkatëse të mos mbeten pa buxhet financiar për të ushtruar kompetencat e tyre në mënyrë të përshtatshme, si dhe, njëkohësisht, për pjesën e plotësimit të akteve nënligjore. Kjo është detyra e ministrit të Drejtësisë, kjo është detyra e qeverisë shqiptare. Për t'iu futur në thelb komenteve, komente mund të bëjë kushdo, por unë nuk mund t'ia lejoj vetes që të bëj komente për sa i përket mënyrës së përzgjedhjes së anëtarëve nëse i plotësojnë ato kritere apo jo.

Për sa i përket drejtësisë selektive, absolutisht jam shumë e bindur, ndoshta ngaqë kam qenë pjesë e kësaj reforme, në pjesën e ekspertëve, kjo drejtësi, në mënyrë absolute, nuk mund të konsiderohet kështu siç është dizenuar, kurrë si një drejtësi selektive, sepse është një drejtësi e re, për të cilën jo vetëm që është punuar fort, për gati 3 vjet, për të krijuar institucionet e reja, në mënyrë që të jenë të pavarura dhe të pakapura nga politika dhe të funksionojnë ashtu siç duhet, si një pushtet i ndarë. Nga ana tjetër, është punuar në bashkëpunim me aktorët ndërkombëtarë, të certifikuar edhe nga Komisioni i Venecias. I gjithë ky është një kapitull i mbyllur. Drejtësia e re në mënyrë absolute, nuk mund të konsiderohet kurrë selektive. Përkundrazi, është një ndër reformat më të mëdha, një ndër reformat më të mira, që mund të ketë bërë Shqipëria për sa i përket sistemit të drejtësisë. Duhet të jemi krenarë, që secili nga ne, me rolin e tij, pak më shumë apo pak më pak, ka ndikuar që kjo drejtësi të miratohet. Shpresojmë që të gjithë ne, edhe ju si anëtarë të këtyre komisioneve, gjithashtu të jeni kontributorë që kjo drejtësi të fillojë zbatimin sa më shpejt. Ashtu siç e tha edhe zoti Dule, është një ndër prioritetet kryesore që Shqipërinë do ta përfshijë në familjen e madhe europiane. Pra, të gjithë bashkë të japim kontributin që të mos e vonojmë, por të fillojmë zbatimin sa më shpejt.

Për sa i përket pyetjes në lidhje me koston potenciale për vendimet e Gjykatës së Strasburgut, mund të them se Gjykata e Strasburgut, për shkak se është Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, është një instrument i gjallë, që përdoret nga të gjithë shtetasit e atyre shteteve që janë palë anëtare të kësaj konvente, kanë të drejtën të aplikojnë kur mendojnë se po cenohet një e drejtë konvendore. Ne nuk mund t'i ndalojmë shtetasit shqiptarë kur mendojnë se për shkak të vendimeve, ndoshta dhe abuzive, të gjykatave shqiptare të dhëna deri tani, të shkojnë ta rikërkojnë të drejtën e tyre në Strasburgu. Nëse kjo është një kosto potenciale, apo jo, kjo do të ekzistojë për sa kohë që ne jemi pjesë dhe palë e konventave europiane.

Nga ana tjetër, dua të theksoj se aktualisht nuk kemi ende vendime të Gjykatës Europiane, që të lidhen me një kosto specifike, sidomos për sa i përket çështjes së pronave, ku është numri më i madh i aplikantëve në Gjykatën Europiane. Për sa kohë që nuk ka ende një

vlerësim na Gjykata Europiane, për sa kohë që Gjykata Europiane, bashkë me komitetin e ministrave, që merren me monitorimin e ekzekutimin të vendimeve të Gjykatës Europiane, pret të marri një vendim në qershor të vitit 2018 apo në shtator të vitit 2018, absolutisht nuk e konsideroj shqetësues faktin se ka një kosto të përcaktuar apo të vlerësuar për këto vendime, që sot, në fakt, nuk janë ende vendime, por janë procese, që presin të marrin vendime nga Gjykata Europiane.

Genc Pollo – Zonja Gjoshë dhe zonja Tabaku kanë pyetje, por do t'ju lutesha që në përgjigje të jeni pak më koncizë dhe t'u referohemi direkt çështjeve. Ju e dini vetë se çfarë do të flisni, por në qoftë se ka një problem konkret në drejtësi, për persona të caktuar, që një deputet ka dyshimin se drejtësia bëhet selektive, ndoshta pohimet e përgjithshme mund të jenë të duhura, por edhe qasjet konkrete ndaj problemit të ngritur do të jenë ato që vlejnë për deputetin që bën pyetje. Në qoftë se nuk ka, në rregull.

Urdhëroni, zonja Gjoshë!

Më pas fjalën e ka zonja Tabaku!

Klajda Gjoshë - Zonja Ministre, realisht ju falënderoj për të gjithë prezantimin tuaj sot! T'ju them të vërtetën, e kuptoj rolin tuaj, sepse e di shumë mirë çfarë do të thotë të koordinosh 3 prioritetet kryesore për sa i përket procesit të integritetit evropian, por jo vetëm, sepse ato janë procese që lidhen direkt me shtetin e së drejtës, me atë shtet që kërkojnë qytetarët shqiptarë të kenë, pra të kenë standardet e duhura. Unë ju dëgjova me vëmendje. Në fakt, ju pak a shumë filluat t'u shmangeshit disa prej pyetjeve që ju bëmë, duke thënë se nuk donit të ngatërronit rolin e ekzekutivit me legjislativin.

Dëshiroj t'ju kujtoj se ekzekutivi është ai që raporton në Komisionin Evropian dhe mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për raportet që dërgohen, për ecurinë e punës që ndërmerr vendi, sidomos në të gjithë prioritetet kryesore. Sot ne kemi një kusht për çeljen e negociatave, duke marrë parasysh këtu se shumë shpejt do të ketë edhe një bisedim mbi Shqipërinë, jo vetëm në prill në Komisionin Evropian, por edhe në qershor në Këshill dhe këto janë muaj shumë të rëndësishëm.

Unë dëshiroj t'ju bëj disa pyetje lidhur me reformën në drejtësi. Ju e monitoroni atë, monitoroni edhe zbatimin e procedurave që ndiqen për këtë reformë, por dua të di: cili do të ishte raportimi juaj për reformën, duke marrë parasysh disa perceptime që ne sot kemi krijuar edhe me vendet anëtare për moszbatimin e kriterëve, që, në fakt, i kemi vendosur vetë në atë reformë, i kemi miratuar me 140 vota? Patjetër që Ministria e Drejtësisë ka qenë drejtuese e këtij procesi. sot kemi të bëjmë me një kryeprokurore të Përgjithshme, të zgjedhur vetëm me

69 vota, në shkelje të plotë të atyre ligjeve, por edhe të ndryshimeve kushtetuese, që i kemi miratuar së bashku; kemi të bëjmë me disa anëtarë të KLGJ-së dhe KLP-së që janë totalisht në shkelje të kriterëve që i kemi vendosur, në fakt, njerëz që kanë të bëjnë dhe me regjimin e shkuar, që në fakt, për historinë e Shqipërisë është e lëndueshme të diskutohet sot në vitin 2018. Në fakt, dua të di cili do të ishte raportimi juaj për ecurinë e vetingut dhe në tërësi të reformës në drejtësi? Pra, cilat do të ishin ato pika që do ta bënin Shqipërinë të çelte negociatat në qershor të vitit 2018?

Së dyti, kam një pyetje që ka të bëjë me 40 ligjet e reformës në drejtësi, që e bëjnë atë të implementueshme. Cili është roli juaj, zonja Ministre, pasi unë shikoj se nga Ministria e Drejtësisë këto ligje vetëm legalizohen, pra nuk ka një rol lidhësi të ministrisë suaj por edhe tuajin personalisht?

Së treti, ka të bëjë me Kodin e Procedurave Administrative, i cili është një Kod që është miratuar prej shumë kohësh tashmë, ku jemi ne me aktet nënligjore? Janë pikërisht këto akte nënligjore, që kanë pezulluar edhe përfundimin e prioritetit numër 1, që ka të bëjë me reformën në administratën publike, e cila tashmë duhet të kishte dalë jashtë atyre prioritetëve kyçe dhe duhet të ishte quajtur e përfunduar.

Faleminderit!

Etilda Gjonaj – Zonja Gjoshë, ju falënderoj për pyetjet, pavarësisht se një pjesë e tyre kanë një përgjigje të njëjtë me ato që thashë më parë! Është e vërtetë që Ministria e Drejtësisë raporton, apo qeveria shqiptare raporton për Komisionin Europian lidhur me prioritetet, por nuk është vetëm qeveria shqiptare që zbaton dhe është përgjegjëse për zbatimin e tyre, prandaj ekzistojnë tri pushtetet. Pa dashur të bëj as leksion dhe as teori, por secili pushtet mban përgjegjësinë e tij lidhur me mënyrën e funksionimit dhe zbatimit të detyrimeve që ka, në kuadër të zbatimit të reformës në drejtësi.

Ministria e Drejtësisë është e vërtetë që nuk ka qenë ose nuk është lider në pjesën e paketës ligjore, sepse nuk ka qenë dhe nuk ka dashur të bëhet e tillë. Në shtator të vitit 2017, kur qeveria e re është mandatuar, Ministria e Drejtësisë ka marrë një rol shumë aktiv për pjesën e mbetur të paketës së reformës ligjore dhe është pikërisht ajo që ju thashë, se pjesë e mbetur kanë qenë ligji “Për ndihmën juridike”, ligji “Për tarifën gjyqësore”, projektligji “Për profesionet e lira” dhe paketa ligjore, sekondare penale.

Në këtë proces ku Ministria e Drejtësisë, jo vetëm po jep komentet dhe po rishikon, por po bën edhe takime me grupet e interesit për të kuptuar se si mund të përmirësohen këto drafte,

të cilat me procedurë parlamentare janë depozituar më përpara me propozim të deputetëve të caktuar.

Ministri i Drejtësisë, për të marrë një rol aktiv nuk mund të zhbëjë një procedurë parlamentare të zhvilluar më parë. Ne sot jemi para këtij fakti, por që Ministria e Drejtësisë ka marrë një rol aktiv dhe nuk po bën thjesht punën e certifikuesit të projektligjeve, sidomos paketës së reformës në drejtësi. Kjo është një gjë absolutisht e sigurt.

Unë nuk dua të vazhdoj të përsëri atë çfarë ne do të bëjmë në vitin 2018 dhe çfarë bëmë deri tani për pjesën e paketës sekondare të ligjeve të reformës në drejtësi, që bëjnë kuorumin e 40 ligjeve, por dua t'ju them se i gjithë procesi jo vetëm po zhvillohet në një kohë jashtëzakonisht të shpejtë, por edhe shumë ambicioz për të arritur afatet të cilat janë vendosur me qëllim që i gjithë kuorumi i paketës ligjore të jetë i miratuar deri në qershor të 2018-ës. Qeveria shqiptare dhe Ministria e Drejtësisë në kuadër të detyrës, përgjegjësisë që ka për të raportuar për prioritetin e dytë, që është reforma në drejtësi, nuk mund të bëjë gjë tjerët veçse të vendosë faktet, argumentet dhe arritjet, të cilat janë realizuar jo vetëm nga qeveria shqiptare, por edhe nga pushtetet e tjera apo institucionet e pavarura. Ministria e Drejtësisë nuk mund të futet as në kompetencat e komisionit të vetingut, as në kompetencat e institucioneve të pavarura për të thënë që ne do të kemi shumë shpejt rezultate të vetingut apo kështu do të zhvillohet procesi.

Ne thjesht monitorojmë dhe koordinojmë se si po zhvillohet ky proces. E pranuar të gjithë që kur miratuar Kushtetutën në vitin 2016, që pushteti gjyqësor të jetë i pavarur nga politika. Ulëm rolin e ministrit të Drejtësisë. Në qoftë se sot në periudhën transitore, ministri i Drejtësisë ka edhe një kompetencë, ka edhe rol në KLD apo edhe në organet e tjera të drejtësisë, me drejtësinë e re i gjithë roli i ministrit të Drejtësisë dhe i qeverisë shqiptare është minimizuar për ta lënë këtë pushtet të pavarur që të vetfunksionojë, me qëllim që të plotësojmë ato kriteret kryesore që kanë të bëjnë me pavarësinë, moskapjen, taransparencën dhe efektshmërinë e sistemit. Kjo është shumë e rëndësishme dhe janë kryesit parime të cilat janë në të gjitha vendet demokratike europiane dhe është ndër reformat e vetme, ashtu siç edhe ju e dini, e pashoq në të gjithë vendet e Ballkanit. Duke marrë përgëzimet e të gjithë ndërkombëtarëve me mënyrën se si janë garantuar të gjitha parimet kryesore që sistemi gjyqësor të jetë funksional dhe të jetë i pavarur.

Për sa i përket Kodit të Procedurave Administrative, aktualisht, për shkak se nuk ka pasur kurrë Ministria e Drejtësisë një dokument analitik të akteve nënligjore që do të propozojë vetë si ministri, ne po bëjmë një punë jashtëzakonisht të madhe, duke bërë jo vetëm këtë plan

që deri dje nuk ka eksistuar, por ndërkohë duke futur në objektiva të vitit 2018 atë punë që nuk është bërë për 10 vjet nga ministrat e mëparshëm të drejtësisë, me qëllim që secili ligj për të cilin ne kemi detyrime për propozuar aktet nënligjore t'u krijohet mundësia që brenda vitit 2018 edhe atyre që u kanë ikur afatet t'i kapin brenda afatit në të gjithë këtë projekt ambicioz me qëllim që të miratojmë akte nënligjore. Të njëjtën gjë do të ketë edhe Kodi i Procedurave Administrative, i cili është përfshirë gjithashtu në plan.

Aldo Bumçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Unë kam dy pyetje për dy çështje. Ju thatë se kjo është një reformë e jashtëzakonshme, e pabërë në asnjë vend tjetër të Ballkanit. Reforma nuk janë letrat dhe institucionet, por janë se si testohen këto institucione në çështje të rëndësishme dhe çështja më e rëndësishme, testi më i rëndësishëm ka të bëjë me hetimin ndaj ish-ministrit të Brendshëm, që lidhet me rastin e ekstradimit të të vetmit person, Nazer Seitaj, financieri i bandës së Habiljve, i vetmi person i kapur në Shqipëri dhe që ishte pjesë e këtij hetimi.

Pra, kjo drejtësi e re ka një test të rëndësishëm, nëse nuk do të ishte emri juaj, nuk do të ishte qeveria juaj në këtë çështje, por do ta studionim si një rast, sikur të ishim në shkollë, çfarë do të thoshit ju që për çështjet më të rëndësishme, ku hetohet ish-ministri i Brendshëm, personi i vetëm i arrestuar në Shqipëri është Nazer Seitaj, ligji shqiptar thotë se kur ka një hetim në Shqipëri ka përparësi ndaj çdo kërkesë për ekstradim dhe çfarë ndodh. Pikërisht, ky person kyç ekstradohet për në Itali, pra shkelet me të dyja këmbët ligji shqiptar. Kjo bëhet për të penguar drejtësinë, sepse në Itali ka një çështje ndaj Habilajve, por jo ndaj Tahirit, ai nuk do të pyetet atje për Sajmir Tahirin dhe kjo çështje këtu ndodh në një kodimin të plotë të të dy institucioneve, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë. Ju jeni fshehur pas faktit që s'keni informacion nga Prokuroria e Përgjithshme dhe shumë e rëndë që si ka mundësi që brenda të të njëjtin institucion të mos ketë informacion një zyrë që zyra tjetër po heton, por kur ky koordinim vazhdon me Ministrinë e Drejtësisë do të thotë që kjo është e planifikuar nga lart për të penguar drejtësinë.

Faktet janë kokëforta. Kjo ka qenë çështja më e bujshme dhe nuk mund të thotë njeri që nuk e dinte që Nazer Seitaj është arrestuar dhe se kjo është pjesë e çështjes “Habilaj”, “Tahiri”, ku është edhe Nazer Seitaj pjesë. Ju keni varësi Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, që ju informon rregullisht, por më e rëndësishmja është se Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kërkuar informacion nga autoritetet italiane nëpërmjet letërporosisë dhe kjo letërporosi kalon nga ju. Në informacion që ju ka kërkuar zoti Alibeaj ju i keni thënë që nuk ka kërkesë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, pra keni gënjyer, sepse në datën 18 tetor 2017 dhe 7 nëntor

2017 keni dy letërporosi në lidhje me informacionin që kërkohet për këtë çështje dhe ju e keni përcjellë këto letërporosi në datat 25 tetor dhe 20 nëntor. Pra, letërporositë tregojnë se keni pasur informacion, pra ato shkresa mbajnë firmën tuaj dhe përsëri keni shkelur ligjin dhe keni firmosur ekstradimin e Nazer Seitajt. Më thoni, më rëndë se kaq, çfarë tjetër duhet të ndodhë? Çfarë tjetër duhej të ndodhte që ne të themi se këtu ka një drejtësi të kapur? Kjo është që të marrësh një dëshmitar dhe ta ekzekutosh në forma të ndryshme. Kjo është një mënyrë ekzekutimi të një personi kyç në një hetim të rëndësishëm. Ministri i Brendshëm i 4 vjetëve për çështjen e kanabizimit të Shqipërisë. Mund të më thoni se më rëndë se kaq, çfarë duhet të ndodhë?

Ku ka këtu drejtësi të re? Këtu ka një drejtësi të kalbur që në fillim. Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë veprojnë njësoj nën urdhrat e ministrit të Brendshëm, se përndryshe nuk mund të kishte mënyrë tjetër se si mund të pengohej, përveçse në shkelje flagrante, skandaloze, të ligjit. Kjo ishte e para.

E dyta lidhet me pronën. Kam 3 pyetje që janë të nënndara për çështjen e pronës. Sa vendime ka trajtuar në këto 5 vjet, që qeveria juaj është në drejtim, Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave? Sepse perceptimi është që agjencia ka ndaluar tërësisht. Në këto 27 vjet kjo është periudha kur agjencia nuk ak punuar, nuk ka trajtuar kërkesat e qytetarëve shqiptarë. Më thoni pra sa kërkesa ka trajtuar këta 5 vjet!

2. Sa është detyrimi që ka shteti shqiptar nga vendimet tashmë të marra? Kam dy të dhëna, njëra është 4,4 milionë euro dhe tjetra 70 milionë euro. Cila prej tyre është e saktë? Për çështje që janë në vijim, vetëm nga 103 çështje që nuk janë të gjitha, janë 224 çështje në shqyrtim nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, shuma e kërkuar është 822 milionë euro. A janë të vërteta këto shifra?

3. Gjykata Kushtetuese, kur trajtoi ligjin e pronës, ndryshimet që ju i bënë (ne dhe disa grupe të tjera e dërguam ligjin si antikushtetues), iu drejtua Komisionit të Venecias për të marrë një opinion. Rezulton që përkthimi i kryer i relacionit dhe i ligjit, që i është dërguar Komisionit të Venecias nga Avokatura e Shtetit, sepse Gjykata Kushtetuese nuk e ka bërë përkthimin e vet, rezulton të jetë me gabime.

Kjo çështje është ngritur publikisht edhe me shkresë nga Presidenti i Republikës Bujar Nishani, drejtuar autoriteteve shqiptare, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, Komisionit të Venecias, ku i kërkohet kjo gjë: që ligji mbi të cilin ato kanë dhënë opinion nuk është versioni zyrtar, por është një përkthim jo i saktë, një version jopërfundimtar i ligjit.

Çfarë keni për të më thënë në lidhje me këtë çështje?

Faleminderit!

Etilda Gjonaj – Zoti Bumçi, nuk besoj se po e ngatërroi me aludimet në atë kohë, kur bëhej fjalë për paketën ligjore të reformës në drejtësi, e cila iu çua Komisionit të Venecias.

Aldo Bumçi – Jo, nuk po e ngatërroj. Bëhet fjalë për ligjin e pronës, dhe Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, ka shkresa, pra qëndrime publike në lidhje me këtë çështje.

Etilda Gjonaj – Unë nuk e kam çuar kurrë këtë pretendim. Vendimi i Gjykatës, edhe në qoftë se ka qenë, është përgjegjësi totale e Gjykatës Kushtetuese, pra një gjë që s' më përket mua. Unë kam si detyrim të zbatoj vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Aldo Bumçi – Pyetja është nëse vendimi është marrë mbi një material jo të saktë, pra Gjykata ka kërkuar opinion nga Komisioni i Venecias. Komisioni ka lexuar një variant të dërguar nga ne.

Etilda Gjonaj – E kuptova, e kuptova pyetjen.

Aldo Bumçi – Atëherë, patjetër që kjo duhet t'ju shqetësojë, sepse nuk është varianti përfundimtar.

Etilda Gjonaj – Në qoftë se do të më linit të përgjigjem, mbase e kam kuptuar drejt pyetjen, gjithmonë nëse do t'ju pëlqejë përgjigja.

Ashtu siç thashë, edhe në cilësinë e ministres së Drejtësisë, edhe si qytetare e thjeshtë, por edhe si profesioniste, nuk mund ta vë kurrë në diskutim një vendim gjykate, për më tepër të Gjykatës Kushtetuese. Kjo do të thotë se unë zbatoj në mënyrë rigoroze vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Se si është bërë procesi, këtë le ta hetojë prokuroria, le ta shikojë Gjykata Kushtetuese, në mënyrë administrative etj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bumçi, ju dëgjova...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju dëgjova. Në qoftë se doni të ma jepni mundësinë për t'i kthyer përgjigje, ma jepni! Në qoftë se nuk ju pëlqen përgjigja, kjo është gjë tjetër. Mbase as mua s' më pëlqejnë disa pyetje, por besoj se nuk jemi këtu për të zgjedhur pyetjet e përgjigjet.

Pra, ashtu siç ju thashë, në cilësinë e ministres së Drejtësisë, kur bëj propozime, sidomos për sa i përket çështjes së pronave për aktet nënligjore, unë kam vetëm detyrimin të zbatoj vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Kjo do të thotë se për mua është e rëndësishme t'i qëndroj urdhërimeve që më jep ajo.

Vendimet e Këshillit të Ministrave, që janë miratuar në dhjetor të vitit 2017, kanë bërë pikërisht këtë: kanë dhënë në mënyrën më të qartë procedurat sipas të cilave do të ndiqet

zbatimi i ligjit për sa u përket dy çështjeve që ngriti Gjykata Kushtetuese. Me procesin brenda, nuk është çështja ime.

Për sa i përket vlerës, kjo ishte një ndër pyetjet e mëparshme, që është kërkuar në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kur themi se është një vlerë e kërkuar, çdo individ ka gjithë të drejtën e tij të kërkojë aq sa ia merr mendja se është dëmi i tij, por kjo nuk përkthehet në një kosto reale, për sa kohë që Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut nuk është shprehur me një vendim. Të shprehen ata, pastaj të kalkulojmë kostot. Çdo person që shkon në gjykatë, edhe në gjykatat shqiptare, mund të kërkojë pafundësisht vlerë financiare në lidhje me dëmin që ai mendon se i është shkaktuar. Por mbase ky dëm nuk i është shkaktuar fare.

Le t'ia lëmë Gjykatës Europiane që të shprehet. Të shohim se si do të jetë ecuria. Njëkohësisht, Gjykata Europiane, së bashku me Komitetin e Ministrave, ashtu siç theksova, ka marrë edhe vendimet e Këshillit të Ministrave, që kanë dalë në zbatim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, që do të shprehen në qershor e në shtator të vitit 2018.

Deri tani nuk kemi asnjë kosto reale për sa i përket vendimeve të Gjykatës Europiane, sepse nuk ka vendime. Kur të ketë vendime do të fillojmë të diskutojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zotëri, më thatë se janë kërkuar.

Aldo Bumçi – Mbajini shënim, pra!

Etilda Gjonaj – Unë i mbajta shënim pyetjet.

Aldo Bumçi – Më vjen keq, ju pyeta: detyrimet e deritanishme janë 70 milionë euro apo 4, 4 milionë euro, sepse kam dy të dhëna të ndryshme.

Etilda Gjonaj – Më duket se më pyetët për 70 milionë euro, lidhur me vendimet që ATP-ja ka marrë, jo për Strasburgun.

Aldo Bumçi – Jo. T'jua sqaroj. Ju bëra dy pyetje: sa janë vendimet e marra tashmë, jo të kërkuara...

Etilda Gjonaj – Nga ATP-ja apo Gjykata Europiane?

Aldo Bumçi – Nga Gjykata e Strasburgut.

Etilda Gjonaj – Po.

Aldo Bumçi – Janë 70 milionë apo 4, 4? Apo është ndonjë shumë tjetër? Sepse unë kam dy të dhëna të ndryshme këtu. Kjo është njëra pyetje. Pastaj është detyrimi i deritanishëm i certifikuar, jo që kërkohet dhe do ta vendosë më pas gjykata.

E dyta: sa është numri i çështjeve që ka trajtuar agjencia juaj në pesë vjet?

Etilda Gjonaj – Po pra. Tani më duket sikur ndryshuan, por megjithatë, po vijojmë pa ju futur debatit.

Për sa u përket vendimeve të Gjykatës Europiane...

Aldo Bumçi – Zonjë, mbani shënim pyetjet. Pyetjet janë po të njëjtat.

Etilda Gjonaj – Për sa u përket vendimeve të Gjykatës Europiane, unë nuk di t’jua them me numër se sa janë si numër total, sepse janë të kategorizuara sipas fushave dhe aktualisht, sot në Gjykatën Europiane presin rreth tetëdhjetë e ca çështje për t’u gjykuar, të cilat lidhen pikërisht me çështjen e pronave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deri tani Gjykata e Strasburgut ka marrë disa vendime, por të cilat nuk kanë ndonjë vlerë të konsiderueshme; unë nuk di t’jua them shifrën në këtë moment, por shifra kryesore që ju përmendni se është e kërkuar, ka të bëjë pikërisht me këto vendime, tetëdhjetë e ca vendime, që janë pending në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut apo në Gjykatën e Strasburgut, siç ju e cilësuat.

Për çështjen e Agjencisë së Trajtimit të Pronave mund t’ju them se në total...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta sqaroj apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tashti, me ndryshimet që pësoi ligji, e të cilat mbetën pezull...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bumçi, të lutem!

Ju thashë edhe një herë: më lini të përgjigjem! Pastaj, ju pëlqen apo jo përgjigja, është çështje tjetër gjë. Ta përfundoj unë? Unë ende s’kam filluar fjalën, ndërsa ju thoni: jo kështu!

Aldo Bumçi – Atëherë, se sa çështje janë trajtuar, kjo nuk ka lidhje me ligjin, zonjë Ministre! Sa ka trajtuar agjencia në pesë vjet? Nuk ka të bëjë me ligjin kjo gjë.

Etilda Gjonaj – A mund të flas? Nëse më lejon kryetari. A mund të flas, apo...?

Tashti, ashtu siç ju thashë, ligji ka bërë që, për një kohë të caktuar, për shkak se ka qenë edhe në gjykatë Kushtetuese, është pezulluar. Normalisht, që në këtë periudhë agjencia nuk mund të kryente veprime, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por, në total evidentohen se janë 26 mijë vendime për kompensim, 10904 prej të cilave rezultojnë të vlerësuara, dhe rezultojnë të vlerësuara në këto pesë vjetët e fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pesë vjetët e fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aldo Bumçi – Sa ka trajtuar në 5 vjet, jo në 27 vjet?

Etilda Gjonaj – Në 5 vjetët e fundit ka trajtuar rreth 10 mijë vendime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aldo Bumçi – 10 mijë vendime? Sepse, ju thatë se s'ka punuar për njëfarë kohe. Sa vendime ka marrë agjencia në 5 vjet?

Etilda Gjonaj – 10 mijë vendime.

Aldo Bumçi – Pra, 10 mijë vendime ka marrë agjencia në 5 vjet?

Etilda Gjonaj – Po.

Aldo Bumçi – Dakord!

Etilda Gjonaj – Për çështjen e Naser Seitajt, unë bëra një interpelancë. Në qoftë se s'u kënaqët me mënyrën se si e drejtoi interpelancën kolegu juaj, zoti Alibeaj, i cili u fut në çështje politike, ndërsa duhej të kishte qëndruar më shumë në çështjet teknike, mund ta kishit drejtuar ju, zoti Bumçi...

Aldo Bumçi – Unë ju bëra pyetje. Ju bëra pyetje dhe kërkoj përgjigje jush. Unë ju bëra pyetje, dhe pyetjet janë...

Etilda Gjonaj – Tashti, kjo pyetje, zoti kryetar, nuk është pjesë e këtij procesi, e kësaj seance dëgjimore që po bëjmë sot, e cila ka të bëjë me pesë prioritetet kryesore. Çështjet e ekstradimit janë çështje funksionale të ministrisë, dhe unë e kam deklaruar: bëhen rreth 200 ekstradime në vit. Për këtë arsye u thirra në interpelancë, ku dhashë sqarimet e mia. prokuroria e rrethit gjyqësor Durrës ka filluar hetimet. Jo vetëm si ministre Drejtësie, por edhe si profesioniste, unë nuk mund të paragjykoj kurrë se çfarë gjykimi e çfarë hetimi do të bëjë prokuroria. Le t'ia lëmë radhën prokurorisë që të japë vendimin. Pas vendimit, secili ka të drejtë të flasë si ta mendojë.

Genc Pollo – Zonja Ministre, një koment, para se ta marrë fjalën zonja Tabaku. Çështjet e drejtësisë dhe çështjet e kriminalitetit janë për Shqipërinë një problem i madh i shtuar në këto vite, si dhe një pengesë në rrugën e saj drejt Bashkimit European. Kësisoj, çështja që ngriti kolegu Bumçi është një çështje brizante dhe përgjegjësia juaj direkte si ministre e drejtësisë, ndaj do të duhej të shpjegohej, nëse nuk është shpjeguar në mënyrë shteruese në interpelancë.

Ajo që unë vura re në interpelancë, duke ju dëgjuar juve me vëmendje, por edhe kolegët, është se ju keni nënshkruar në vjeshtë dy letërporosi në lidhje me hetimin penal të Naser Seitajt,

drejtuar palës italiane, ndërsa para disa javësh keni nënshkruar një letër drejtuar një deputeti të opozitës, ku thoni e nuk dini gjë për këtë hetim penal.

Unë magjepsem nga mënyra se si e ruani qetësinë, duke qenë edhe juriste e duke e ditur si mund të zhvillohen gjërat sot e nesër. Megjithatë, kjo është për t'u vlerësuar.

Në qoftë se nuk keni gjë për të thënë apo për të shtuar, kolegu Bumçi, unë, e ndoshta edhe të tjerët, do të donim të dëgjonim më shumë detaje në lidhje me çështjet dhe përgjegjësitë direkte politike dhe administrative. Se çfarë nxjerr hetimi penal i Prokurorisë së Durrësit, unë jam dakord me ju, që duhet t'u lëmë kohë atyre që të punojnë, të veprojnë, që pastaj të shohim rezultatet e të gjykojmë mbi to.

Sa për çështjen në fjalë, është një çështje që nuk mund të ikë nga tryezat tona, e aq më pak nga mendjet tona, por le të jemi qytetarë të përgjegjshëm dhe përfaqësues të përgjegjshëm të qytetarëve të Shqipërisë.

Etilda Gjonaj – Zoti Pollo, në qoftë se më lejoni...

Genc Pollo – Po, patjetër!

Pastaj e ka fjalën zonja Tabaku, për të bërë një pyetje. Pas saj zonja Spiropali.

Etilda Gjonaj – Zoti kryetar, nëse më lejoni, këtë qetësinë e kam për shkak se jam juriste; është një procedurë normale, funksionale e Ministrisë së Drejtësisë prej shumë vitesh, prandaj jam e qetë, sepse procedura është bërë ashtu siç është bërë në të gjitha procedurat e ekstradimit dhe siç e parashikon ligji. Shpresoj ta kuptoni që edhe këto kërkesat apo dokumentet që ju i citoni, që janë përgjigjet e mia apo të letër-porositve, të kuptohet një gjë që janë dokumente të klasifikuara dhe shpresoj që secili anëtar i këtij komisioni apo kush i lexon nëpër medie të ketë plotësuar kriteret ligjore, për sa i përket mënyrës se si trajtohet materiali apo informacioni i klasifikuar.

Genc Pollo – Nuk ishte kjo tema.

Zonja Tabaku, ka pyetje.

Jorida Tabaku – E falënderoj ministren për prezantimin dhe për materialin që i ka dërguar paraprakisht komisionit!

Në fakt, kam pyetje për tri çështje:

Së pari, ngre me shqetësim faktin që antikorrupsioni tashmë është pjesë e detyrave të zonjës ministre. Më parë, qeveria “Rama 1” kishte një ministër, i cili merrej me çështjet e antikorrupsionit dhe e kishte vendosur këtë si prioritet. Nuk është se kishte ndonjë rezultat konkret, sepse çështja e antikorrupsionit është çështje vullneti dhe unë nuk e pres nga kjo

qeveri, por sidoqoftë kishte një vëmendje më të madhe dhe të paktën një prezantim më serioz në lidhje me planin e punës për antikorrupsionin.

Strategjia e zgjerimit të Bashkimit European jep detyra dhe prioritetë të qarta në lidhje me çfarë duhet të bëjë qeveria për antikorrupsionin, po kështu edhe rekomandimet e Komitetit të Stabilizim-Asociimit, që ne i pamë në fillim të kësaj jave. Janë disa elemente që ju nuk i keni paraqitur në raportin dhe prezantimin tuaj.

Së pari, kur do të ngrihet SPAK-u, i cili do të sigurojë hetimin e zyrtarëve të lartë, që të kemi rezultate konkrete në luftën ndaj korrupsionit?

Së dyti, çfarë masash po merr qeveria shqiptare për prokurimet publike, që në mënyrë të rallë dhe të veçantë janë paraqitur në strategjinë e zgjerimit si një problem kryesor që prek edhe Shqipërinë? Investimet publike, të cilat jepen me tender të drejtpërdrejtë, si dhe investimet publike, të cilat shkojnë vetëm te disa klientë të qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Çfarë mendimi keni për marrëveshjen e Prokurorit të Përgjithshëm me Policinë dhe Ministrinë e Brendshme? A ka kjo mbivendosje mbi detyrat që do të ketë SPAK-u dhe a siguron hetime të pavarura në luftën ndaj korrupsionit?

Çështja e dytë, që dua të diskutoj, është çështja e pronave, të cilën e preku pak edhe kolegu Bumçi, si pjesë e rekomandimeve të Komitetit të Stabilizim-Asociimit. Anëtarët e opozitës insistuan që të ishte pjesë edhe zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, gjë që u vendos edhe në rekomandime. Qeveria shqiptare, megjithëse Gjykata Kushtetuese ka marrë vendimin në nëntor të vitit 2016, deri në dhjetor të vitit 2017 nuk bëri asgjë për të reflektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Kështu që ose Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vepruar në paligjshmëri, ose vendimet e Këshillit të Ministrave, që dolën në dhjetor të 2017-ës, janë zbatuar pa u miratuar akoma, ose do të shkaktojnë një kosto për buxhetin, që ne do ta shohim në vijim, në qoftë se kjo agjenci ka marrë vendime ashtu siç thoni ju.

Kam këtu një përgjigje, zoti Bumçi, që u referohet këtyre shifrave. Në cilësinë time si deputete, zonja Ministre, ju kam pyetur se cila është kostoja që qeveria shqiptare do të ketë për çështjen e pronave në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut në Strasburg dhe në Gjykatën e Arbitrazhit? Përgjigjja juaj është: “Vlera financiare nga kërkuesit për 103 çështje është 822 milionë euro”. Me të drejtë kërkuesi mund të kërkojë një shumë çfarëdo dhe duhet të vendosë gjykata, por ajo që është e rëndësishme në përgjigjen që më keni dhënë ju është se kjo është e bazuar, e vlerësuar mbi çështjen pilot “Manushaqe Puto”. Kjo do të thotë, që meqenëse gjykata ka dhënë një çështje pilot, me një vlerë të caktuar, atëherë të gjitha çështjet që do të trajtohen

pas kësaj, do t'i referohen kësaj çështjeje. Ne këtë diskutimin e kemi pasur bashkë edhe në Komisionin e Ekonomisë.

Shqetësimi që ne ngremë është se, së pari, qeveria ka vepruar në mënyrë antikushtetuese me ligjin e pronave, që në vetvete edhe ai vetë është antikushtetues, por pak rëndësi ka se nuk i futemi dot këtij diskutimi, sepse ju e thatë që gjykata ka marrë një vendim, por edhe me atë vendim të Gjykatës Kushtetuese ju keni shkelur me të dyja këmbët vendimin për një vit të plotë, sepse pas një viti keni miratuar VKM-të.

Së dyti, shteti shqiptar, me të gjitha këto vendime që janë në radhë në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ka një detyrim të jashtëzakonshëm dhe për këtë arsye ne themi që çështja e trajtimit të pronave nuk po merret seriozisht.

Së treti, në lidhje me reformën në drejtësi, e lexova me vëmendje raportimin që institucioni juaj i ka dërguar këtij komisioni.

Së pari, këtu raportohet për gjëra të kryera gjatë vitit të kaluar, të cilat për ne, sigurisht, janë shumë të rëndësishme, sepse në qoftë se sot flasim për një reformë në drejtësi dhe për një paketë ligjesh të miratuara falë kësaj reforme, këto vijnë si rezultat i votës që opozita ka dhënë. Një sërë ligjesh që ju keni përmendur këtu, janë të gjitha të miratuara dhe pak flitet për ardhmen se çfarë do të ndodhë.

Dua të ngre edhe dy shqetësime:

Së pari, për buxhetin e organeve të vetingut. Raportuesi i parlamentit gjerman, zoti Frai, vetëm ditët e fundit ngriti shqetësimin që organet e vetingut kanë ende vështirësi për t'u ngritur, për arsye të buxhetit. Ne e diskutuam buxhetin në dhjetorin e vitit të kaluar dhe organet e vetingut kishin pakënaqësitë e tyre. Ju thatë që buxheti ishte i mjaftueshëm. Sot e kësaj dite kemi institucione, të cilat ende kanë vështirësi për buxhetin, që u përmend edhe nga eurodeputeti gjerman zoti Frai.

E dyta, meqenëse keni qenë edhe eksperte e reformës në drejtësi, çfarë mendimi keni për faktin që qeveria shqiptare, parlamenti miratuan një listë me anëtarë të KLP-së dhe të KLGJ-së, që nuk merrte parasysh rekomandimet e ONM-së? Kolegët e mi këtu i paraqitën të gjitha problemet që kishin anëtarët e KLP-së dhe të KLGJ-së, duke filluar që nga dekriminalizimi, të akuzuar për hetime të krimeve të komunizmit, duke vazhduar me lidhjet politike, të cilat qartësisht shkelin kriteret e ligjit.

Në fund, kisha diçka në lidhje me burgjet. Ju paralajmëruat një reformë të madhe në burgje dhe thatë se: “që kur kjo qeveri ka filluar mandatin në vitin 2017”, dua t'ju kujtoj që qeveria e ka filluar mandatin në vitin 2013. Nuk mund të vini të flisni ju dhe çdo përfaqësues

tjetër këtu sikur keni vetëm 1-2 muaj që jeni në detyrë, keni që në vitin 2013 që jeni në detyrë dhe nuk është bërë absolutisht asgjë për të gjitha çështjet që unë përmenda, por për burgjet në veçanti.

Të paktën, jemi njohur që të gjithë drejtorët e burgjeve, por njëkohësisht edhe të hipotekave, pa përmendur më pas spitalet e me radhë, sepse nuk janë çështje që ju i ndiqni, kanë lidhje politike. Pra, ne jemi njohur me lidhjet politike që kanë këta persona. Sa e siguron kjo eficiencën, pavarësinë e institucionit nga politika dhe reformimin e institucionit për ta çuar atë më pranë standardeve të BE-së?

Faleminderit!

Genc Pollo – Faleminderit!

Para se t’ia jap fjalën zonjës ministre, në lidhje me çështjen që ngriti kolegja Tabaku dhe kolegu Bumçi, siç duket ju nuk e keni sot shumën totale në euro të vendimeve me fuqi ekzekutive të marra nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut për çështjen pronësore të Shqipërisë dhe si pasojë detyrimin nga buxheti i shtetit për të shlyer këto shuma në ekzekutim të këtyre vendimeve. Pra, meqë ju nuk i keni këto të dhëna sot, ju lutem të na i dërgoni që komisioni të njihet me shumën e akumuluar. Pra, shumën e vendimeve pa përfshirë vendimet në shqyrtim, por vendimet që kanë përfunduar, konkrete dhe me detyrim ekzekutimi, është një shifër të cilën komisioni do të donte ta dinte, nëse ju e keni.

Etilda Gjonaj – Zonja Tabaku, në prezantimin që bëri e tha shumë qartë. Edhe në përgjigjen që ka ardhur nga Ministria e Drejtësisë në bazë të përgjigjes që ka marrë nga Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, bëhej fjalë për një shumë të kërkuar. Është e vërtetë që të gjitha këto kërkesa dhe aplikime kanë shkuar në kuadër të shqyrtimit pilot “Manushaqe Puto”, ku ka edhe një plan veprimi se si do të zbatohet plani i veprimit i Manushaqe Putos, i gjykimit pilot që ka marrë Gjykata Europiane.

Zonja Tabaku, ishte më e artikuluar në sqarimin që bëri, sepse është pikërisht një shifër e kërkuar. Është e vërtetë për sa kohë që është një shifër e kërkuar, është shifra që unë kam dhënë përgjigjen në shkresën drejtuar zonjës Tabaku, e cila ka qenë shumë aktive në të gjitha çështjet e pronave që i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë për informacion. Pra, nuk kemi ende vendime gjykate të dhëna dhe nuk mund të shkojmë me aludime se Gjykata Europiane do të japë të njëjtin vendim, ashtu siç kanë dhënë për gjykimin pilot të “Manushaqe Putos kundër Shqipërisë”, sepse kjo është arsyeja që Gjykata Europiane ka kërkuar pikërisht ndryshimin e ligjit dhe zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Për sa i përket çështjes së antikorrupsionit, ku ministri i Drejtësisë është i veshur me rolin e ri si koordinator kombëtar antikorrupsion, sot jemi në fazën ku po përgatisim planin e ri të veprimit 2018-2020, po asistohemi fort nga Bashkimi European dhe pikërisht nga delegacioni i pranishëm këtu me ekspert, për të përgatitur pasaportën e indikatorëve që ky të jetë një mekanizëm i matshëm nesër, si dhe për të thënë që në luftën kundër korrupsionit lidhur me këtë prioritet janë arritur këto rezultate. Janë pikërisht ekspertët e delegacionit europian, të cilët po bëjnë këtë ushtrim për Ministrinë e Drejtësisë, por edhe në rang kombëtar.

Lidhur me çështjen e SPAK-ut, se kur do të ngrihet, ligji thotë se SPAK-u ngrihet 2 muaj pas ngritjes së KLP-së dhe KLGJ-së. KLGJ-ja dhe KLP-ja ngrihen në momentin që mbaron procesi i vetingut për anëtarët gjyqtarë dhe anëtarët prokurorë që do të jenë pjesë e KLGJ-së dhe e KLP-së.

Kuvendi e ka bërë pjesën e tij, duke zgjedhur me short anëtarët e KLGJ-së dhe të KLP-së. Sot presim rezultatet nga komisioni i vetingut, ku edhe këta kandidatë, të cilët vijnë nga gjyqtarët dhe nga prokurorët për institucionet e reja të KLGJ-së dhe të KLP-së të vetohet, pikërisht janë përfshirë në listën prioritare 57 subjektet e para. Presim rezultatet e para, me qëllim që këta kandidatë të konsiderohen të vlefshëm dhe të kalojnë procesin e vetingut, institucionet e reja fillojnë menjëherë nga funksionimi i tyre. Dhe dy muaj më pas do të ngrihet SPAK-u. Dhe unë mendoj që brenda vitit 2018 këto organe duhet të ngrihen.

Për sa u përket masave që po merren për prokurimet publike apo investimet publike, po prapë të rolit të koordinatorit kombëtar antikorrupsion, pikërisht plani i ri i masave do të jetë shumë më efektiv, me qëllim që të ketë një numër më të vogël masash për të mos pasur shumë, sepse ato që kanë qenë, kanë qenë me efekt parandalues, të asistuara përsëri nga Komisioni European nëpërmjet një projekti *twining*, i cili na ndjek hap pas hapi.

Po tentojmë që të kemi një plan veprimi masash më të kufizuara në numër, por njëkohësisht që të jetë më efektiv në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë edhe masat që duhet të merren për transparencën, masat që duhet të merren për integritetin e funksionarëve të lartë, apo dhe të administratës publike, masa që do të merren edhe për pjesën e investimeve publike. Kur dokumenti të përfundojë, zonja Tabaku, të jeni të sigurt që do ta bëjmë publik, pse jo të diskutojmë dhe për masat që do të jenë të vendosura, indikatorët e vendosur në këtë dokument.

Nuk mund të komentoj marrëveshjen që është bërë ndërmjet prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Brendshme. Me aq sa e njoh unë atë paketë, modestisht e them, që nuk ka asnjë edhe një lloj mbivendosjeje, përplasje, apo zëvendësim të organeve të SPAK-ut. Ajo

marrëveshje, me aq sa unë kam dijeni, duke qenë dhe anëtare e task forcës qendrore në luftën kundër krimit të organizuar, nuk ka të bëjë fare me pjesën e parashikimeve lidhur me organet e SPAK-ut, apo byrosë së hetimit.

Për sa i përket reformës në drejtësi, buxheti për institucionet e reja të vetingut, besoj për këtë ishte fjala, gjithashtu dhe unë pata një takim me zotin Frai, i cili, gjithashtu, e shtroi si pyetje. Ashtu siç i thashë dhe atij, me përgjegjësinë më të plotë, di t'ju them se buxheti që është kërkuar nga institucionet e vetingut, iu është vënë në dispozicion, aq sa është kërkuar nga ata. Kjo është vërtetuar dhe në mënyrën funksionimit normal të tyre.

Aktualisht Ministria e Drejtësisë është në fazën e përfundimit të ristrukturimit të zyrave të Kolegjit të Apelit dhe komisionerëve publikë që do të jenë pikërisht në ish-zyrat e KLSH-së, për të cilat gjithashtu është marrë një fond i konsiderueshëm nga buxheti i shtetit, me qëllim për të pasur të gjithë elementët e sigurisë. E kuptojmë që janë zyra të cilat kanë një klasifikim me elementët e sigurisë, por njëkohësisht për t'u dhënë të gjitha mjetet, pajisjet, infrastrukturën, logjistikën e nevojshme, për funksionimin e tyre normal. Sot kolegji i pavarur i kualifikimit funksionon normalisht aty ku dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit zhvillon veprimtarinë e tij në mesin e ish-Lidhjes së Shkrimtarëve.

Për sa i përket reformës në burgje, që kemi lançuar, shumë shpejt do të lançojmë edhe dokumentin e politikave për sa i përket kësaj reforme, e cila do të jetë një reformë kapilare. Unë nuk gabova kur thashë në shtator të 2017-s, sepse gjendja që gjeta në Ministrinë e Drejtësisë ishte lidhur me mënyrën se si ishin bërë rekrutimet e stafëve. Mjafton t'ju kujtoj rekrutimin e stafit për burgun e Reçit të Shkodrës, një muaj përpara fushatës zgjedhore apo në vigjilje të fushatës zgjedhore. Vetëm për ta kujtuar, mund t'ju them se si ka qenë gjendja lidhur me pjesën e rekrutimeve.

Për sa u përket rekrutimeve, që unë si ministre Drejtësie, së bashku me administratën përkatëse, dhe institucionet përgjegjëse, kam bërë për sa u përket drejtuesve të institucioneve penitenciare, mund t'ju them se janë emëruar 24 drejtorë. Për ta u bë një thirrje publike. Pra, u shpallën vendet vakante në mënyrë publike ku u bë dhe një konkurs. Gjithashtu dhe në urdhrin që nxori ministri iu dha prioritet atyre personave që kishin shërbimin ushtarak me grada të larta dhe që kishin pasur nivele drejtuese në shërbimin ushtarak. Dhe sot që flasim nga 24 burgje, 18 prej tyre janë ish-ushtarakë, kolonelë, gjeneralë me grada shumë të larta, që nuk kanë as një lloj lidhjeje as me Partinë Socialiste, as me politikën dhe me asnjë lloj partie. Është zgjedhur në burgun e grave një grua. Është vendosur që në burgje të cilat kanë pasur një kategori të veçantë të dënuarish apo të paraburgosurish, të kenë qenë juristë apo punonjës

socialë. Pra, i gjithi ka qenë një proces totalisht transparent, i normuar, sepse nuk ka pasur kurrë normim për procedura të tilla. Pra, i normuar dhe i rregulluar në atë mënyrë që të garantohej në fund meritokracia dhe e gjithë transparenca e këtij procesi.

Zonja Tabaku, ju vlerësoj shumë, sidomos për pyetjet që keni bërë. Ju kam vlerësuar dhe gjatë kësaj periudhe që ju keni kërkuar informacion të vazhdueshëm në këtë periudhë të Ministria e Drejtësisë. Por, do t'ju lutem që kësaj pyetjeje për të cilën unë iu përgjigja përpara të mos i përgjigjem përsëri, sepse nuk është pjesë integrale e kompetencës, e përgjegjësisë sime që t'i futem në meritë se çfarë ka thënë ONM-ja dhe çfarë procedure ka kryer Kuvendi.

Jorida Tabaku – Qëparë folët si eksperte e reformës në drejtësi, prandaj jua bëra këtë pyetje, si eksperte e reformës në drejtësi, por ju zgjidhni që të mos përgjigjeni.

Nuk është e vërtetë që organet e vetingut kanë marrë të gjithë buxhetin që ata kanë kërkuar. Organet e vetingut kanë pasur një buxhet të reduktuar me 1/3-n. Ne e kemi diskutuar këtë bashkë në Komisionin e Ekonomisë dhe kjo është e vërteta. Organet e vetingut kanë pasur kërkesa më të larta. Unë nuk e di nëse ju e keni takuar reporterin për Shqipërinë në parlamentin gjerman, përpara apo pas deklaratës së tij, por dëgjova shqetësimin e tij pikërisht për Kolegjin e Apelit, që ju sapo e përmendët. Akoma ky kolegji është pa zyra dhe nuk është funksional. Shpresoj që kjo që thoni ju të jetë e vërteta dhe ndoshta ai informacionin mund ta ketë marrë më vonë. Në qoftë se Ministria e Drejtësisë ka një detyrë në këtë proces, ajo është thjesht sigurimi i mjediseve, zyrave që procesi të fillojë dhe t'i sigurojnë pavarësinë, jo gjë tjetër.

Faleminderit!

Etilda Gjonaj – Misioni i Pavarur i Kualifikimit, që ndodhet te godina e ish-Lidhjes së Shkrimtarëve, së bashku me ONM-në, funksionojnë normalisht pa asnjë lloj pengese në të gjithë logjistikën, infrastrukturën etj. Kolegji i Apelit, i cili ende nuk ka filluar të funksionojë, sepse pritet vetëm KPK-ja që është Kolegji i Pavarur i Kualifikimit të dalë me vendimet e para, të cilat më pas kundërshtohen te Kolegji i Apelit si një shkallë e dytë gjyqësore, do të fillojë funksionimin. Zyrat e tyre janë duke përfunduar dhe janë pikërisht në zyrat e ish-KLSH-së për të cilën ne po punojmë me 3 turne për t'i përfunduar ato.

Genc Pollo – Kam një koment dhe unë, zonja Ministre, sepse ju dëgjova me vëmendje.

Besoj këtu kemi qenë të gjithë, ju keni qenë ministre, kur ka pasur një debat të madh në Kuvend. Kërkesa buxhetore e organeve të vetingut është përgjysmuar nga ana e qeverisë dhe ka pasur shpjegime të qarta nga ana e qeverisë. Ka pasur dhe kundërshtime, dhe kundërgjegjësi nga opozita, dhe nga një pjesë e organeve të vetingut. Prandaj ajo që thuhet se ata morën aq sa kërkuan, është një e pavërtetë e certifikuar. Është debat tjetër nëse buxheti

u mjafton ose jo, dhe ka shqetësime të ngritura edhe në rekomandimet e miratuara nga të gjithë deputetët tanë eurodeputetët për infrastrukturën dhe buxhetin e vënë në dispozicion të organeve të vetingut, në mënyrë që ata ta bëjnë punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe efektive. Por të themi që ne si Kuvend kemi miratuar atë që kërkuan, unë dhe një herë e theksoj se kjo gjë është e pavërtetë. Nuk e di nga ana juaj nëse ka qenë vëmendja e duhur në atë kohë. Ne jemi këtu për t'i thënë gjërat në përgjigje të pyetjeve që dëgjojmë, në kompetencën tonë ose jo.

Fjalën e ka kërkuar zonja Spiropali.

Elisa Spiropali - Faleminderit!

Faleminderit, zonja Ministre për prezantimin shterues! Për të diskutuar këtu për prioritetet 2, 3 dhe 5, që bien në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë, ne duhet të kthehemi pas në kohë për të parë kontekstin ku ka operuar jo vetëm ministria, por edhe qeveria shqiptare. E para, kontekstin ku ka operuar Ministria e Drejtësisë dhe qeveria, duke nisur që nga viti 2013, që me të drejtë e përmendi dhe zonja Tabaku. Tani kemi një reformë në drejtësi që është drejt finalizimit, e cila është ideuar, mbështetur, shtyrë përpara dhe tani po ekzekutohet dhe finalizohet falë vullnetit të kësaj maxhorance, të kësaj partie, të kësaj qeverie. Për këtë besoj të gjithë qytetarët janë të qartë. Ka qenë në programin tonë. Me shumë guxim, me shumë vullnet kjo qeveri i është futur reformës në drejtësi që nuk është e thjeshtë. Dhe nuk flas vetëm për këtu te ne, por në të gjithë Ballkanin Perëndimor, ashtu siç rezulton edhe nga raportet e Bashkimit European.

E dyta, unë pata rastin të isha në Strasburg, në prezantimin për strategjinë e Ballkanit të zonjës Mogerini, ku u theksuan disa gjëra për shtetet e ndryshme, për 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe për Shqipërinë u theksua posaçërisht se është bërë progres në të gjitha prioritetet kyçe dhe veçanërisht në reformën në drejtësi. Kjo ishte e vërteta që u tha jo vetëm aty, me zë dhe me figurë, por edhe në çdo tavolinë, në takime me eurodeputetët. Kishte një mbështetje të jashtëzakonshme për reformën në drejtësi dhe pa diskutim, është një meritë e parlamentit shqiptar, por mbi të gjitha, e vullnetit që ka treguar kjo qeveri për ta shtyrë përpara dhe këtë nuk mund ta mohojë askush.

Tani të kthehemi tek ajo që duhet të bënte parlamenti apo veçanërisht opozita, për reformën në drejtësi, se, që është e rëndësishme për integrimin, të mos them thelbësore, këtë e dinë të gjithë. E dinë edhe fëmijët, e dinë edhe pleqtë, e dinë edhe burrat, e dinë edhe gratë. E dinë të gjithë qytetarët shqiptarë, që në shumicën e tyre, duan të jenë pjesë e Bashkimit European,

Më 18 dhjetor, opozita shqiptare protestoi në Kuvend me një formë të paprecedentë. Aty u hodhën shishe, u shkulën letra dhe u hodhën drejt qeverisë, ministres së Drejtësisë dhe kryeprokurores së Përgjithshme të përkohshme, fluturuan këpucë, u referua dhe u kthye në simbol çadra e ngritur në 2017-n.

Pse të gjitha këto? Mos janë të rastësishme? Mos ishte një protestë spontane?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. Është diskutim imi dhe besoj se do të ma lejon pas 5 diskutimeve të opozitës.

Pa diskutim!

E gjitha kjo nuk ishte rastësore. Ishte një strategji, e cila vazhdon: strategjia e tensionit të vazhdueshëm për reformën në drejtësi.

Ju kujtoj se u ngrit një çadër për të penguar procesin e vetingut. U vonua votimi i 7 ligjeve për reformën në drejtësi dhe këtë ministri mund ta thotë, sepse është përgjegjëse për procesin. U kundërshtua zgjedhja e kryeprokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm, kur kryeprokurorit *former*, siç i referohet edhe raporti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i Departamentit të Shtetit, i kishte mbaruar mandati. Pra, protestuan që të mbanin në detyrë një kryeprokuror, i cili tashmë është shpallur *non grata*...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

...në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për të cilin ka një deklaratë zyrtare të Departamentit të Shtetit.

Ndërkohë, procesi i reformës në drejtësi dhe vetingu kanë filluar të japin rezultatet e para dhe nuk ka gjë më të rëndësishme se kjo për procesin e integritetit të Shqipërisë. Si? Po vetëlargohen nga sistemi gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët nuk duan të kalojnë përmes vetingut.

Kemi rastin e gjyqtarëve të Apelit të Durrësit, ku përmes procesit të verifikimit dolën çudira, që u ishte paguar bileta nga të pandehurit.

Kemi ish-kryeprokurorin, i cili nuk pranoi të kalojë përmes procesit të vetingut. Pra, një gjë shumë e rëndësishme dhe thelbësore po ndodh në sistemin tonë të drejtësisë, që po ndryshon jo vetëm strukturën, por edhe njerëzit që do ta përbëjnë këtë strukturë.

Jo më larg se dy ditë më parë, ne ishim së bashku, zoti Pollo, në Komitetin e Stabilizim-Asocimit, ku ky fakt, pra reforma në drejtësi, u theksua.

Është një reformë progresiste, avangarde edhe për rajonin. Serbia dhe Mali i Zi, të cilat kanë filluar të negociojnë, pra janë ulur në tryezën e BE-së, ende nuk e kanë kryer këtë reformë

dhe do t'u duhet ta kryejnë në vazhdim. Pra, Shqipëria ka një avantazh të qartë në këtë drejtim, të cilin nuk mund ta mohojë askush.

Jemi shumë pranë çeljes së negociatave me Bashkimin European dhe duhet të lëmë mënjanë të gjitha këto që unë përmenda, pra kundërshtitë e vazhdueshme me zë, me figurë, me vepra, me protesta, me çizme, me çadra, ndaj kësaj reforme. Të mos merremi me bishtat por të merremi me thelbin, që është: a duhet ta çojmë përpara këtë reformë, apo jo?

Ne jemi shumë shpresëplotë si maxhorancë, që procesi i vetingut dhe reforma në drejtësi kanë filluar të japin rezultatet e para dhe në muajt në vazhdim, që janë shumë të rëndësishëm për procesin e integritetit, ne do të kemi edhe më shumë rezultate, të cilat mund t'i prezantojmë në tryezën e Bashkimit European, për të thënë atë që ju çuditërisht e thoni edhe përpara kamerave, përpara shqiptarëve, po e po, por e thoni edhe përpara partnerëve tanë, dhe hasni në rezistencën e tyre, siç e hasët në Komunitetin e Stabilizim-asociimit, pra në kundërshtinë e tyre të hapur, me dokumente, me rezultate për luftën kundër krimit, për luftën kundër korrupsionit, për luftën kundër kultivimit të kanabisit, për reformën në drejtësi. Jua paraqitën dhe në fund, pa diskutim, ne miratuam një deklaratë të përbashkët, se ishte e vetmja rrugë për të ecur përpara. Uroj shumë që në frymën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...e kësaj deklarate të përbashkët që ne miratuam, edhe në muajt në vazhdim, opozita t'i kthehet këtij boshti dhe të mbështesë jo vetëm reformën në drejtësi, por gjithë procesin e prioritetëve dhe çeljen e negociatave në fund, sepse ju kujtoj se çelja e negociatave hap një kapitull të ri transformimi për Shqipërinë, në të gjitha fushat e veprimtarisë politike, ekonomike, shoqërore të vendit. Është mirë për opozitën, është mirë për ne, por mbi të gjitha, është mirë për qytetarët, që presin këtë përgjegjshmëri nga klasa politike shqiptare.

Faleminderit!

Genc Pollo - Faleminderit shumë, zonja Spiropali, për pyetjen tuaj në formën e një diskutimi të gjatë!

Për të saktësuar çfarë u tha në Komisionin e përbashkët të Stabilizim-Asociimit, ju e dini fare mirë që rendi i ditës, i propozuar nga Parlamenti European, për herë të parë në historinë tonë dhe pa krahasim me ndonjë vend tjetër kandidat, përmbante kanabisin, dhe deklaratat, rekomandimet përmbajnë kanabisin dhe drogat e rënda...

(Deputetja Elisa Spiropali flet pa mikrofon)

Elisa Spiropali -... përmbanin kanabisin, të tyre fare. Ta saktësojmë këtë.

Genc Pollo – Ju lutem, lexoni pikën (e kam me vete) 11 të rekomandimeve, për të cilat ju keni votuar!

(Deputetja Elisa Spropali flet pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Dhe u theksuan rezultatet në luftën kundër kanabisit në vitin 2017.

Genc Pollo – U theksua kalimi nga kanabisi te drogat e rënda.

Ju lutem, lexoni rreshtin 3 të pikës 11!

Persone – Zoti Pollo, ju lutem!

Genc Pollo – Ndoshta do të kemi kohë për të diskutuar pasi të mbarojmë mbledhjen.

Persone – Ajo është konsumuar para syve të publikut.

Genc Pollo – Dokumenti zyrtar është në *website*-n e Kuvendit.

Persone – Ju i mbani mend kundërshtimet e hapura që hasët jo vetëm nga zonja Makove, por edhe nga të tjerët, por ky nuk është vend për diskutim.

Genc Pollo – Pjesa e fundit e fjalisë suaj është shumë me vend.

Persone – Nuk është ideale ta diskutojmë këtë, sepse e dëgjuan të gjithë.

Genc Pollo – Faleminderit, për diskutimin tuaj!

Nuk dëgjova pyetje, por, gjithsesi, është e qartë.

Ka kërkuar fjalën zonja Duma dhe më pas zoti Tushaj.

Grida Duma – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja Ministre, ju keni një përgjegjësi sa ekzekutive, edhe politike, shumë të rëndë. Kur them “të rëndë” nuk nënkuptoj vetëm faktin që është e gjerë dhe me shumë përgjegjësi.

Nga ana tjetër, diskutimi i madh sot është reforma në drejtësi, e cila për qeverinë është kthyer në shumë momente në kalin e betejës, në flamurin e fitores, në certifikatën e ecjes përpara, por nuk duhet të kthehet në kalin e Trojës. Pse e them këtë? Nëse do të flasim në planin politik dhe ekzekutiv, ne si Komisioni i Integritetit presim me shumë dëshirë hapjen e negociatave, që Shqipëria të vazhdojë përpara, por hapja e tyre lidhet me pikën e parë, reformën në drejtësi.

Ju, siç jeni, ministra, pjesë e ekzekutivit, jeni edhe figura politike dhe çdo tentativë për t’iu larguar politikës dhe për t’u fshehur te procedurat tregon dobësi, sepse ne duhet të kthejmë përgjigje konkrete nëse kemi arritur apo jo rezultate.

Nuk është në të mirën e Shqipërisë ta shikoni opozitën vetëm si një instrument që duhet të thotë “po, po, po dhe bravo”. Të gjithë thonin se reforma në drejtësi duhet t’i largohet politizimit, duhet ta largojë gjyqësorin nga politika. Sot maxhoranca absolute është e një partie të vetme dhe shqetësimi më i madh i ndërkombëtarëve, i Brukselit dhe i Komisionit të Venecias

është: A është e mundur që një parti e vetme politike të sigurojë që ndërtimi i mekanizmave të drejtësisë do të jetë jopolitik? Diskutimi që keni pasur ju si maxhorancë me opozitën ka qenë gjithmonë se si të sigurojmë që kjo parti politike e vetme të ketë realizuar produktin jopolitik në drejtësi.

Pa diskutim që zgjedhja e Kryeprokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm ishte hap prapa. Pse? Sepse, megjithëse u miratua paketa e reformës në drejtësi, u parashikua me një ligj të futur pas reformës, një ligj aneks, *ad hoc*, çengel, se do të kishte një krizë pas 1 viti dhe nuk do të mund të zgjidhnim KLP-në dhe KLGJ-në. Domethënë, hajde të nxjerrim një ligj çengel për të prodhuar një sistem të ri ku Kryeprokurori i Përgjithshëm të zgjidhej edhe me 36 vota. Pikërisht vetingu, që po kërkohet dhe po flitet plotësisht, nuk u zbatua për Kryeprokurorin e Përgjithshëm të përkohshëm. Kjo nuk ka lidhje me emrin e kryeprokurores. E nderuar ose jo, nuk i jemi futur kurrë emrit të kryeprokurores. Nuk ka lidhje absolutisht as me palët në këtë diskutim. Por, nëse ju presupozoni se opozita nuk duhet të thotë asnjë ditë se është këtu për të ruajtur balancën, sepse në asnjë shtet demokratik nuk mund të ruhet nëse sistemi gjyqësori zgjidhet vetëm me votat e një partie dhe pa monitorimin e opozitës, pasi është një iluzion i madh politik, dhe jo të pretendoni konstruktivizëm nga opozita.

Unë ju dëgjova me shumë vëmendje. Ju kam dëgjuar edhe në interpelancë. Ju doni ta shmangni çështjen e ekstradimit duke kaluar ping-pongun, ishte përgjegjësi, e dija apo nuk e dija, të gjitha procedurale. Një ditë të bukur ne mund t'i anashkalojmë edhe si procedurë ose të keni mundësinë institucionale t'i anashkaloni, por sot nuk është e mundur të anashkalojmë nëse është bërë ndonjë dëm në çështjet e drejtësisë apo jo.

Ministri juaj i Brendshëm, në dijeninë time, ka thënë se po të ishte në atë pozicion, nuk do ta kishte kryer ekstradimin, nuk ka qenë opozita. Në njëfarë mënyre, është pranuar se është kryer një dëm. Ju do të thoni: a është përgjegjësia ime absolute, a jam unë vetëm një ekzekutiv i thjeshtë që kaloj në zinxhirin e tretë të kësaj historie? Unë nuk dua t'i hyj kësaj çështjeje. Mund të jetë kështu, por unë jam e bindur se si profesioniste, si ministre, si një brez i ri në politikë, po të doni, ju e kuptoni qartë se është kryer një dëm. Kjo çështje do t'u provonte, ndoshta jo opozitës, por shqiptarëve, së pari, dhe ndërkombëtarëve, të cilët e kanë diskutuar dhe kanë shkruar qartë se hapja e negociatave varet nga reforma në drejtësi, se pikërisht kjo maxhorancë, që ka kalin e betejës reformën në drejtësi, e fillon nga vetja, sepse kjo është sfida që keni. Sfida nuk është as ekzekutivi i vogël, as drejtorucë, as diskutimi për dy drejtorë, qofshin të opozitës, por edhe tuajt, siç ka ndodhur në sistemin e hipotekave në Kavajë. Nuk është kjo sfida, ju e dini shumë mirë. Të flasim konkretisht dhe pastër për këtë çështje. Sfida

është krimi i organizuar dhe i lidhur me politikën. Nga shqetësimet që ju ngrini, se janë të gjitha procedurale, nuk dëgjova në asnjë moment të thoni: zotërinj parlamentarë, shqetësimi që kemi është buxheti i strategjisë antikorruption. Pse e ngremë ne këtë? Pse themi se është buxheti dhe nga kolegët është bërë disa herë kjo pyetje? Është buxheti, sepse diskutimi sot, i thënë edhe nga katër ambasadorë të nderuar në Shqipëri, të cilët kanë ndihmuar për reformën në drejtësi, është se paraja e zezë që lëviz në tregun shqiptar, e ardhur nga krimi i organizuar, kalon 4-fish buxhetin e shtetit shqiptar. Pyetja e përkthyer në terma konkretë është: si do të mundet një gjyqtar me një rrogë sa 1/100-ta e një krimi të lidhur me pushtetin të luftojë krimin e organizuar dhe paratë e pista?

Unë jam e bindur se edhe ju e dini, por nuk po e prekim sa duhet. Holanda kërkon rikthimin e regjimit të vizave për shqiptarët, sepse argumenton se paraja e zezë, që vjen nga krimi i organizuar me origjinë Shqipërinë, është e pakontrollueshme. Në raportet e policisë holandeze ata bëjnë edhe ironi dhe thonë: “Një ditë të bukur do të ngrihemi në mëngjes dhe do të themi se hotelet, turizmin dhe restorantet në bulevardin e Amsterdemit janë në pronësi të mafies shqiptare”.

Sot jemi në këto situata dhe nuk dëgjohet në asnjë moment për një konkretësi të vetme, cili është rezultati. Ne flasim për procedurë, plan veprimi, monitorim, por nuk themi asgjë konkrete. Ka rezultat për këtë çështje apo jo?

Unë dëgjova një të vërtetë të frikshme të thënë nga ju për sa u përket burgjeve, e vetmja që ndaluar ju dhe e thatë me shqetësimin e duhur. Në fakt, është një shqetësim shumë i madh. Ju thatë se i keni gjetur burgjet në një situatë të rëndë dhe sfida jonë është që kontrollojmë në burgje të mos e ketë krimi, por ta ketë dora e shtetit. Me këtë që thatë ju pohuat se edhe në institucionet e dënimit kontrollojmë e ka krimi, jo dora e shtetit.

Thatë se në burgje ka një mbingarkesë dhe nuk folët në asnjë moment për një proces zhvillimi apo zgjidhje për këtë situatë. Çfarë është kjo? Është e pamundur që asnjë institucion penitenciar të përballojë me kapacitete që të burgosni për krime me natyrë varfërie, vjellje, hajdutërie, siç i çoni njerëzit, për 10 apo 20 mijë lekë. Sistemi i drejtësisë ka një mekanizëm tjetër për këtë, shërbimin e provës, që na siguron se në rastin që kemi të bëjmë me një krim që vjen nga varfëria, nga gjendja e keqe ekonomike, nga devianca e dhunës brenda familjes, apo nga ndihma ekonomike, që i hiqet dikujt dhe më pas i kërkohet fatura e dritave. Ju si ministre Drejtësie duhet të parashikoni se shërbimi i provës duhet t’i fusë në rehabilitim këta njerëz, jo në burgosje, sepse edhe nga pikëpamja ekonomike, një i burgosur në burgjet shqiptare kushton mesatarisht 40-50 euro, ndërkohë që elementi që ju kërkoni ta ndëshkoni, vepra penale që ka

kryer, është 30 mijë lekë në muaj. Ju kushton 40 euro në ditë. Nga ky moment ne kemi një problem, një *gap* të madh të strategjisë së zhvillimit dhe të aplikimit të një drejtësie eficiente, sepse ky është i gjithë diskutimi.

Ne jemi Komision Integrimi dhe sigurisht në komisione të tjera ju keni arsye më madhore për t'u ndalur, por krimi i organizuar dhe çështja e pronës... Unë ju sjell vetëm një shembull konkret. Avokati i Popullit ka ngritur çështjen se janë me dhjetëra dhe me qindra raste kur qytetarët nuk marrin dokumentin e prishjes kur u prishet banesa. Tashmë e dokumentuar në dokumentacionin e Avokatit të Popullit, si do të zgjidhet çështja kur vet shteti ka shkelur të drejtat e njeriut dhe nuk ka çuar dokumentin, që, pasi i është prishur shtëpia dikujt, ndoshta pa të drejtë, nuk po e marrim plotësisht gjithmonë me të padrejtë, por në gjysmat, në 2 apo 10 % të rasteve pa të drejta, ai të shkojë në gjykatë të ankimohet dhe një ditë të bukur t'i njihet e drejta të marrë diçka nga kjo padrejtësi e shkatërrimit të pronës së vetme që ka pasur.

Ju flisni gjithmonë për përgjegjësi që dalin jashtë jush, por, nëse ka një sfidë për të kuptuar që po fillon reforma në drejtësi, dhe që na çon drejt hapjes së negociatave që na vlejné të gjithëve, absolutisht, është sfida për të filluar nga sistemi, që tregon se ka kredibilet që nga vetë maxhoranca. Momenti i fundit që ju thashë, ndoshta i fundit i zinxhirit, ku shteti, INUK-u apo të tjera elemente shkelin të drejtat e njeriut, çfarë bëhet me këtë situatë?

Ashtu siç ju thashë, edhe në nivel drejtësie, ka një dëm me një ekstradim, i cili nga pikëpamja institucionale mund të kalojë pa asnjë ndëshkim, por nga pikëpamja e drejtësisë funksionale, ju e dini, në një farë mënyre e keni vetëpranuar që mund të humbim në kalenda procedurash, por nga ana tjetër, nuk mohojmë dot se kemi humbur edhe një gjykim për këtë çështje të rëndësishme.

Faleminderit!

Genc Pollo – Faleminderit!

Kemi komente nga ministrja?

Etilda Gjonaj - Pyetje nuk pashë, kështu që më lejon të bëj vetëm dy komente që të mos përsëris ato që rithashë disa herë.

Për sa i përket situatës në burgje, më vjen mirë që zonja Dume më ka ndjekur me vëmendje, por i ka shpëtuar elementi që për të ulur mbipopullimin, i cili sot është rreth 220 apo diçka më pak mbi kapacitetin, deri në fund të shkurtit apo ditët e para të marsit do të inaugurohet burgu i ri i rrethit të Shkodrës, i cili ka 750 vende, që do të thotë se mbipopullimi që është sot në burgje, do të jetë një problem i eliminuar shumë shpejt.

Për sa u përket çështjeve të dënimeve alternative apo ato çfarë u përkasin shërbimeve që i monitoron, i ndjek dhe i ekzekuton Shërbimi i Provës, si institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, jepen me vendim gjykate. Ministri i Drejtësisë mund të orientojë nëpërmjet përfshirjes, propozimit në Kodin Penal të më shumë dënimeve alternative, por nuk mund të detyrojë kurrësi gjykatat që të japin më shumë dënime alternative. Ne kemi një rol, duke bashkëpunuar me Shkollën e Magjistraturës ku bëjnë trajnimet vazhduese për magjistratët, së bashku me ekspertët e huaj japim rëndësinë pse duhet të aplikohen sa më shumë dënime alternative. Ky është roli i Ministrisë së Drejtësisë.

Për sa u përket rezultateve të para të reformës në drejtësi, unë themi që i kemi këto rezultate dhe janë pikërisht dorëheqjet e fundit që janë bërë për anëtarë, ish-prokurorin e Përgjithshëm, të cilët ishin në listën prioritare për t'u vetuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Rezultatet e para kanë ardhur. Të jemi të duruar, sepse ashtu siç e kanë deklaruar edhe ndërkombëtarët, do t'i bëjmë të ditura shumë shpejt rezultatet se si do të shkojë procesi i rivlerësimit kalimtar për këtë listë prioritare për krerët e sistemit gjyqësor.

Për sa i përket zgjedhjes së prokurorit të Përgjithshëm, do të ndalem në dy, tri gjëra, jo vetëm si teknikene, por edhe si Ministre Drejtësie. Mund t'ju them se janë zbatuar në mënyrë rigoroz procedurat e parashikuara në ligj për zgjedhjen e prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm. Janë pikërisht këto dispozita tranzitore që janë vendosur me asistencën e organizatave, të aktorëve ndërkombëtarë si Komisioni Europian, EURALIUS, ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me OPDAT-in.

Gjithsesi, dua t'ju garantoj vetëm për një element të fundit që ka Ministria e Drejtësisë në këtë periudhë dhe për vitin 2018. Ne po punojmë ngushtësisht me të gjithë aktorët ndërkombëtarë, që të gjitha elementet, që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe luftën kundër tij, me reformën në drejtësi, si dhe të drejtave të njeriut, si tri prioritetet kyçe, të ecim së bashku në vitin 2018 që të kemi rezultate konkrete dhe mundësi që edhe reforma në drejtësi të ecë përpara, por edhe lufta kundër korrupsionit, gjithashtu.

Faleminderit!

Genc Pollo – Fjala për zotin Tushaj dhe zotin Ulqini më pas, por, duke qenë se u mbushën fiks dy orë nga fillimi i mbledhjes, do të konsideroni të jeni pak më koncizë.

Viktor Tushaj – Më falni, zoti kryetar, për procedurë. Duhet ta ndajmë seancën e pyetjeve dhe të diskutimeve, por ne i bëmë të gjitha bashkë.

Unë dua të falënderoj ministren për ekspozenë e gjerë që bëri, por edhe përmes përgjigjeve që dha për ato tri pika të rëndësishme që ka Shqipëria si detyrim për të aderuar në

Bashkimi European, për reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe të drejtat e njeriut. Në fakt, për secilën prej këtyre pikave apo prioriteteve unë do të doja të bëja pyetje, pavarësisht se pyetja e parë u ezaurua nga kolegët, por jo shumë nga përgjigja dhe as nga interpelanca që zonja ministre bëri në seancë plenare për ekstradimin e Seitaj-t, si dëshmitari kyç, por si një ndër efektet kryesore të reformës në drejtësi. Uroj që ministria të dijë ta mbrojë veten nga ky akt i paprecedent i ekstradimit të dëshmitarit kyç në një çështje kaq madhore dhe sensitive për gjithë shqiptarët.

Për luftën kundër korrupsionit si prioritet, do të ndalesha te çështja e pronës dhe funksionimi i hipotekave. Kur studionim në drejtësi, më kujtohet që kur vinte kapitulli për hipotekat, ne me shaka i thoshim njëri-tjetrit: “Erdhi kapitulli i magazinës së letrave”. Në fakt, këto institucione, nga një magazinë dokumentacioni, u kthyen në një institucion shumë të rëndësishëm të dhënies së pronës, i tjetërsimit të saj, i fshirjes së kufijve mes këtyre pronave, i mbivendosjes së këtyre pronave. A e ndjen përgjegjësinë Ministria e Drejtësisë dhe ju si ministre, për të bërë një luftë të jashtëzakonshme për t’i shkuar deri në fund çështjes së pronave në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë mirëfunksionimit të këtyre institucioneve, të zyrave të regjistrimit të pasurive, pasi, në kuadër edhe të reformës institucionale që po bën qeveria shqiptare, është krijuar një anarki e paparë? Qytetarët shqiptarë me muaj të tërë nuk marrin përgjigje në zyrat e regjistrimit të pasurive. Uroj që drejtori i ri, të cilin e njoh, pasi e kam pasur vartës, të bëjë një punë të mirë në këtë drejtori në zyrat e regjistrimit të pasurisë! Por sa e mbështet ministria në këtë iniciativë, pikërisht për të bërë një reformë institucionale, por edhe për t’i shkuar çështjes së pronave deri në fund? Kjo ishte pyetja e dytë.

Pyetja e tretë ka të bëjë me prioritetin e të drejtave të njeriut. Marr shkas nga disa ndodhi që u kanë ndodhur disa bashkëqytetarëve të mi jashtë kufijve të Shqipërisë. Çfarë përgjegjësie ndjen Ministria e Drejtësisë për të gjithë ata që kanë vdekur nëpër burgjet e Europës, në Francë, Greqi? Në burgun e Greqisë ka humbur jetën një bashkëqytetar imi, Pëllumb Marnikollaj. Familjarët e tyre nuk gjejnë paqe deri sa të dalë në shesh e drejta. Pse janë vrarë këta qytetarë shqiptarë? Pra, a ka përgjegjësi Ministria e Drejtësisë në hedhjen e dritës, në dhënien e informacionit të mjaftueshëm për familjarët e tyre, me qëllim që qytetarët shqiptarë të gjejnë atë që kërkojnë e që u ka munguar deri tani?

Faleminderit!

Genc Pollo – Faleminderit, zoti Tushaj!

Fjala për zotin Velaj.

Fatmir Velaj - Zonja ministre tha që është nga reformat më të shkëlqyera që po ndodhin në Europën Juglindore, dhe këtë e pranoj. Është fakt se Shqipëria po bën reformën në drejtësi, duke e krahasuar me vende të tjera si Serbia, për shembull, që reformën në drejtësi e ka marrë si prioritet pas hapjes së negociatave, Shqipëria më herët tregon se ka një prioritet karshi të tjerëve. Të mos harrojmë që në Rumani e Bullgari, sidomos në Rumani, hyri në vitin 2007, pasi nuk u pranua në vitin 2004 në dhjetëshen e parë dhe iu lanë edhe disa prioritete të tjera, edhe ajo e ka filluar reformën në drejtësi pasi ka hyrë në Bashkimin Europian. Po të keni parasysh Adrian Nastase, që ka qenë Kryeministri i Rumanisë deri në vitin 2004, ai është arrestuar në vitin 2012. Pra, kjo tregon se rumunët jo se nuk e dinin që ai kishte bërë zullum atje ku kishte qenë, por që reforma në drejtësi u zhvillua gjatë viteve më pas. Unë jam i bindur që reforma në drejtësi është në rrugën e duhur dhe do të japë frytet e duhura.

Genc Pollo – Faleminderit, zoti Velaj!

Fjala për zonjën ministre në lidhje me pyetjet dhe komente e bëra nga zoti Tushaj.

Etilda Gjonaj – Po i kthehem edhe një herë për herë të fundit çështjes së ekstradimit. Nuk është akt i paprecedent, të kuptohemi drejt, është një akt normal procedural, i cili ka vite që ndiqet nga të gjithë ministrat e Drejtësisë, është një rast, që ka ndjekur procedurën normale, si çdo rast tjetër ekstradimi.

Ministria e Drejtësisë trajton rreth 200 vendime ekstradimi në vit, për të mos folur pastaj për procedurat e ndërmjetme ose procedurat e tjera të këtyre rasteve, që u përkasin marrëdhënieve juridiksionale me jashtë. Ekstradimi nuk sjell asnjë dëm, sepse ekzistojnë të gjitha mjetet dhe instrumentet ligjore që të kryhen hetime të përbashkëta, që asnjë provë të mos humbasë dhe Prokuroria e Krimeve të Renda të kryejë të njëjtat veprime, siç bën për të gjitha rastet tjera. Më shumë nuk zgjatem në këtë çështje se është konsumuar.

Sa i përket reformës së pronës, unë e përmenda edhe më herët, që ajo është një reformë në të cilën ne jemi investuar si qeveri që po e ndërmarrim për ta zgjidhur dhe për t'i dhënë drejtim çështjes së pronës, për shkak të të gjitha problematikave të evidentuara deri tani, si: mbivendosja, mospasja e titullit të pronësisë nga ata që disponojnë sot një vendim për AMTP-të ose për të regjistruar të gjitha lejet e legalizimit. Pra, janë një sërë hapash që qeveria shqiptare i ka konsideruar ndër prioritetet kryesore dhe kjo është arsyeja që do t'i trajtojë në mënyrë të integruar nëpërmjet ngritjes së kësaj agjencie të integruar ku pa diskutim edhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ashtu siç ju e përmendët, do të jetë pjesë e saj si magazina e fundit që ka dokumentet e titujve të pronësisë.

Sa i përket të dënuarve jashtë shtetit, Ministria e Drejtësisë nuk ka juridiksion ose kompetenca për këto të dënuar, por si rrjedhojë e marrëdhënies së bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërsjellë me shtete të caktuara, kemi nënshkruar marrëveshje ekstradimi, marrëveshje transferimi e të tjera, sepse jemi palë e konventave që funksionojnë në këtë fushë. Pra, ne kemi marrëdhënie bashkëpunimi, por sa na lejojnë kompetencat tona, pa u futur në sistemet penitenciare të atyre vendeve tjera. Në të gjitha rastet kur është e mundur, sa herë na drejtohen shtetasit ose familjarët e shtetasve shqiptarë, që ndodhen në burgjet e huaja, ne kemi shërbyer edhe si interlokutorë për të marrë informacione ose për të ndjekur problematikën që ata kanë pasur.

Faleminderit

Genc Pollo- Mendoja se ishim nga fundi, por ka dy pyetje nga zonja Duma dhe Spiropali.

Grida Shqina- Zonja Ministre, ju thatë që rezultatet e para të reformës në drejtësi kanë ardhur sepse disa gjyqtarë kanë dhënë dorëheqjen. Mendoj se duhet të shkojmë pak më tej dhe të shpresojmë edhe të planifikojmë një sistem drejtësie, i cili nuk i mat rezultatet, kur disa njerëz ikin nga frika. Besoj se kjo do të jetë deviza juaj. Jo kur disa njerëz tërhiqen nga frika, ne mund të mendojmë se kemi bërë një sistem drejtësie.

Nga ana tjetër, ju thoni se e zgjidhëm problemin, sepse jemi duke ndërtuar infrastrukturë në burgun e Reçit. Unë mendoj se një drejtësi e mirë është ajo parandaluese, jo drejtësia ndëshkuese. Nuk duhet të gëzohemi se kemi më shumë vende për të burgosur dhe më shumë dëshirë për të ndëshkuar. Çështja është të ndalemi pikërisht të njëjloj strategjie zhvillimi, e cila dënon kur krimi është koshient dhe nuk vjen nga rrethanat dhe situatat e varfërisë ose të pamundësisë. Unë si profesioniste mendoj se duhet të funksiononi edhe në rolin e koordinatorit kombëtar për të shkuar drejt një drejtësie parandaluese, e cila nuk ndëshkon dhe vetëm ndëshkon ose ushtron frikë, por parandalon dëmin, sidomos kur ai vjen jo për shkaqe të individit, por për shkaqe të rrethanës sociale, të pamundësive e të tjera.

Në Shkodër ka shqetësime për ndihmën ekonomike, madje kudo në vend, sepse janë rreth 20 mijë individë të varfër, të cilët janë hequr nga skema e ndihmës ekonomike. Ju mund të thoni se ç'lidhje kanë me ju. Por, unë ju them se, si njohëse e shoqërisë, ato janë kontingjent i parë për të kryer krime, sepse, nëse një individ nuk ka mundësi shkon patjetër në krimin e rrugës dhe i shtohet faturës suaj, për të cilin duhet të përgjigjet çdo ministër dhe qeveria juaj.

Etilda Gjonaj - Unë doja të bëja një saktësim. U përmend këtu fakti që Holanda ka kërkuar heqjen e regjimit të vizave me Shqipërinë, pra kthimin e regjimit të vizave. Kjo e

pavërtetë. Dua t'ju sqaroj se ministri i Jashtëm jo më larg se dy muaj më parë ka qenë në takim me ministrin e Jashtëm të Holandës. Në komunikim të vazhdueshëm me qeverinë e Holandës, Ministria jonë e Brendshme dhe Ministria e Jashtme ka sqaruar shqetësimet që ata kanë pasur dhe unë ju them se në asnjë moment nuk është kërkuar kthimi i regjimit të vizave.

Së dyti, u përmend këtu fakti se flitet shpesh në media për krimin dhe mafian shqiptare dhe për uzurpimin e restoranteve ose pronave të tjera të holandezëve nga mafia shqiptare. Me gjithë respektin tim, këto janë zëdhënie të qarqeve më ksenofobe dhe raciste të këtyre vendeve, për të cilat edhe vetë qeveritë e shteteve të Bashkimit Europian nuk janë krenare. As ne nuk na bën nder t'i sjellim në këtë tryezë ose kudo tjetër çështje të tilla. Shqiptarët nuk janë as më mafiozë, as më kriminelë, as më vrasës dhe trafikues se qytetarët e vendeve të tjera, nuk ka krim etnik shqiptar. Ballkani ka një problem me çështjet e krimit, njësoj si të gjithë dhe Shqipëria nuk dallon në këtë pjesë. Shqipëria nuk dallon në këtë pjesë, për të mos thënë që në shifrat zyrtare, po të shikoni shifrat e Ministrisë së Brendshme, shqiptarët nuk renditen aspak në vendet ose popujt problematikë. Pa diskutim që ka qarqe ksenofobe për mos të thënë raciste edhe në Europë, por nuk na takon ne këtu si deputetë ose edhe si shqiptarë që t'u japim zë.

Grua- Faleminderit, zoti kryetar. Në fakt, seanca ka zgjatur më shumë se dy orë, por unë do të doja shkurtimisht të theksoja faktin që është e vërtetë që ne kërkojmë një seancë dëgjimore me ministrin e Drejtësisë për një problematikë të rëndësishme dhe për prioritetet që tashmë dihen. Fundi i kësaj seance e tregoi sa e interesuar është opozita për këtë çështje. Unë do të doja të dija sa do të ishte influenza juaj si kryetar i Komisionit të Integritetit dhe e gjithë kolegëve si anëtarë të integritetit për të bërë bashkë opozitën të ketë të njëjtin bashkëpunim dhe të njëjtën qasje si maxhoranca për reformën në drejtësi. A do të ishte influenza juaj e domosdoshme për qytetarët shqiptarë? Unë mendoj që po. I mirëpres të gjitha diskutimet e kolegeve që u larguan dhe të koleges që është këtu dhe të të gjithë të tjerëve, por unë kam një merak të madh se fryma e bashkëpunimit për të çuar përpara këto tri vendime shumë të rëndësishme, që ju diskutuat sot, si: çështja e pronave, të cilën ju nuk e keni pasur asnjëherë në vëmendje për shumë vite, dhe nuk e keni zgjidhur...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Bumçi, më lini të flas, kam kohën time!

Atëherë, nëse do ta kishit pasur prioritet, zoti Bumçi, ju keni pasur edhe pozicionin drejtues, do t'i kishit dhënë zgjidhje atij prioriteti që ka qenë për shqiptarët ndër vite.

Gjithashtu, unë do të thosha që me insistimin tuaj për ta çuar përpara reformën në drejtësi, ne kemi një shans shumë të mirë edhe për 14 ligjet e tjera, që ju ta tregoni në parlament dhe shpresoj që do ta tregoni.

Faleminderit!

(Ndërprerje incizimi)

Genc Pollo- ... për pyetjen të cilën ju i drejtuat opozitës dhe jo ministres, së cilës po ashtu vetë i dhatë përgjigje, edhe neve patjetër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani kësaj seance i erdhi fundi. Unë e lashë për në fund që të bëj një koment dhe një pyetje. Ju thatë që personeli i burgjeve nga një kontroll i bërë, rezultoi në një përqindje shumë të lartë i përbërë nga njerëz me të kaluar penale. Ju keni jetuar 4 vjetët e fundit në Shqipëri dhe nuk do të habiste asnjë nga ata që kanë ndjekur zhvillimet, sepse të tillë ka pasur edhe në Kuvend, edhe në krye të bashkive, edhe në administratën shtetërore në nivel drejtorësh. Pra, nuk kemi pse të habitemi, nëse ju rezulton e tillë gjendja në Policinë e Burgjeve dhe në përgjithësi në personelin e tyre. Zëvendësimi, largimi i tyre patjetër që është gjë pozitive, por ju thatë se do t'i merrni ose janë marrë kryesisht nga ushtria. Të shikojmë politizimin e tyre, nëse personat me të shkuar penale do të largohen, personeli i politizuar që mund t'i zëvendësojë ata, mendoj se mund të mbetet shqetësim dhe në të ardhmen, pavarësisht nga kriteret që vendosëm, do të jetë në fokus, sepse nga kjo gjë ka vuajtur administrata shqiptare jo vetëm 4 vjetët e fundit, por edhe më herët.

Ju thatë ndër të tjera, se do të ndryshoni edhe ligjin për shërbimin e provës dhe si arsye paraqitët problemet e sigurisë që kanë byzylykët e personave në shërbimin e provës. Kjo gjë është diskutuar nga paraardhësit tuaj në ofiq për sigurinë e sistemit dhe problemet që mund të dalin nga mungesa ose siguria e pamjaftueshme e sistemit. Këtu ndoshta mund të na jepni më shumë detaje, sepse është çështje me interes, pasi shërbimi i provës ka qenë një reformë e hershme, lehtësuese për gjendjen e burgjeve, aspektet sociale të saj, që i ngriti kolegja Duma, por ligji, të gjithë e dimë, ne që jemi marrë nuk të pengon të bësh specifikimet e duhura, t'i pasqyrosh ato në mënyrë të duhur në kontratë dhe të kontrollosh se si zbatohet kontrata. Pra, lidhjen midis ndryshimit të ligjit dhe problemeve të sistemit kontrollues të byzylykëve nuk e shikoj të qartë për sa ju thatë. Ndoshta mund ta shtjelloni. Kjo ishte pyetja konkrete e fundit.

Nuk shikoj ndonjë koleg apo kolege të kërkojë fjalën. Ndoshta me përgjigjen tuaj mund të mbyllim edhe mbledhjen.

Etilda Gjonaj - Zoti kryetar, faleminderit për pyetjen!

Nuk mund të rri pa dhënë një specifikim për atë që ju komentuat lidhur me punonjësit e Policisë së Burgjeve që janë gjetur me rekorde penale në institucionet penitenciare, unë nuk përmenda numër, nuk thashë se është një përqindje e lartë, përqindja do të dalë në bazë të numrit total, si rregull, por ajo që dua t'ju them është zëvendësimi i tyre, meqenëse është shqetësim. Ne bëmë një eksperiment në burgun e rrethit të Shkodrës, ishte hera e parë që pilotohej, ku punonjësit e Policisë së Burgjeve në Shkodër, një pjesë e tyre, një pjesë e vogël pritet të rekrutohet shumë shpejt, janë rekrutuar nëpërmjet Akademisë së Sigurisë, që do të thotë se bëhet një testim fizik, një testim njohurish nga kjo e fundit, e cila sot ka një infrastrukturë, strukturë të ngritur që funksionon shumë mirë, në një kohë që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk e ka pasur. Ideja është që në të ardhmen të mundet që të gjitha rekrutimet të bëhen nëpërmjet Akademisë së Sigurisë, të mos jetë më as ministri, as drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve apo drejtori i një institucioni për të vendosur dhe për të emëruar punonjës të Policisë së Burgjeve, për t'i dhënë një herë e mirë fund emërimeve politike në Policinë e Burgjeve.

Për sa i përket shërbimit të provës, unë nuk thashë që do të ndryshojë ligji për shërbimin e provës, aktualisht nuk ka ligj për të, është sjellë me propozim të një deputeti një projektligj i ri, për të rregulluar shërbimin e provës. Ekziston ligji “Për mbikëqyrjen elektronike”, pa diskutim, i cili rregullon një dënim alternativ apo një masë që gjykata e jep për alternativë, por ligj për shërbimin e provës është ky i riu, i cili është projekt.

Për sa i përket problemit nëse ka funksionuar apo ka ekzistuar në këtë periudhë për mbikëqyrjen e elektronike, posaçërisht, ka të bëjë me atë që thatë ju: sistemet, jo se ka një keqfunksionim apo ligji “Për mbikëqyrjen elektronike” është i shkruar keq, por ka pasur një mungesë të përcaktimit të termave të referencës, të kontratës dhe të tjera, të cilat sot janë objekt i një hetimi penal nga Prokuroria e Tiranës, ku ashtu siç e thatë paraardhësi im zoti Bardhi e kallëzoi këtë gjë në prokurori, kjo e fundit e pushoi çështjen, unë e kundërshtova në gjykatë. Kjo e fundit e ka rikthyer për hetim. Presim rezultatet që do të dalin lidhur me këtë sistem të ngritur për mbikëqyrjen elektronike nga Prokuroria e Tiranës.

Pa diskutim, edhe për shkak të *background-it* tim, kryesisht kriminologe, penologe e kam shumë të rëndësishme që dënimet alternative të funksionojnë ashtu siç duhet, sidomos mbikëqyrja elektronike, e cila është një zhvillim shumë normal në të gjitha vendet e BE-së. Kjo është për sa u përket mbikëqyrjes elektronike dhe shërbimit të provës. Do të mundohemi të nxisim gjykatat nëpërmjet aktorëve dhe interlokutorëve të tjerë, siç është Shkolla e Magjistraturës që të aplikojnë sa më shumë dënime alternative për të pasur një drejtësi

rehabilituese dhe jo vetëm për kategoritë e të miturve apo gratë, por njëkohësisht për të gjitha kategoritë e tjera të të dënuarve apo atyre personave që marrin një vendim gjykatë. Në thelb të të gjitha politikave që po ndjekim është ajo që përmendi zonja Duma: parandalimi. Një drejtësi parandaluese me qëllim që të mos jemi gjithmonë në drejtësinë reaguese. Kjo është pjesë e të gjitha politikave që po ndjekim.

Faleminderit!

Genc Pollo - Faleminderit!

Nuk rri dot pa bërë edhe dy komente të shkurtra, por jo për të zgjatur bisedën. Ju thatë se do t'i rekrutoni nga Akademia e Sigurisë, unë përmenda nëpërmjet Akademisë së Sigurisë, se kemi pasur në këta 4 vjet probleme jo vetëm në Kuvend, jo vetëm në drejtori, jo vetëm në bashki, por një problem serioz në atë që qeveria e quajti “policia, si e duam”, e kemi pasur edhe në polici, dëshmuar nga shumë burime, me akuza. Pra, duhet pasur kujdes se Policia e Burgjeve mund të mos jetë shumë e ndryshme në parime apo në tundim, nga ajo që kemi pasur në organe të tjera të ngjashme, pasi harrova ta përmend këtë.

E dyta, nuk është kritikë në vetvete. Ju thatë se paraardhësi juaj në detyrë dhe ju çështjen e byzylykëve dhe dyshimet që kishit për sigurinë e tyre e kallëzuat penalisht që ta hetonte prokuroria, që mund të jetë rruga e duhur, por nuk përjashton hetimin administrativ të ministrisë dhe nxjerrjen e konkluzioneve, vendimeve përkatëse nga vetë organi shtetëror, që në këtë rast është Ministria e Drejtësisë, sepse shpeshherë në të kaluarën nuk lidhen me Ministrinë e Drejtësisë është parë e udhës që të çohet nëpërmjet një kallëzimi penal në prokurori dhe atje të harrohet në kalendat greke dhe çështja mbetet pa u trajtuar. Ajo që është e detyrueshme në një organ apo dikaster që është përgjegjësia konkrete administrative e këtij të fundit, mbetet jetim dhe nuk ndodh.

Drejtësia penale është gjë tjetër dhe nëse ka një shkelje administrative të verifikuar nga punonjës të caktuar, titullari merr masa sipas legjislacionit, është një parim i vjetër, por që shpesh nuk ka ndodhur në vendin tonë. Nuk e kisha për rastin konkret...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...për t'u mbuluar penalja nga përgjegjësia direkte që është në shtëpi. Kam përvojën time, kam parë shumë raste të tilla. Nuk po e zgjasim më shumë.

Falënderoj kolegët dhe koleget!

Në radhë të parë zonjën ministre, bashkë me stafin e saj, të cilët nuk patën mundësi të flasin para komisionit! Besoj se ishte një shkëmbim me vlerë.

Do t'ju njoftojmë për mbledhjen e ardhshme.

Këtu mbyllim mbledhjen.

MBYLLET MBLEDHJA